



KOLEGJI UNIVERSITAR
BEDËR

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

KOLEGJI
UNIVERSITAR
BEDËR

2021



NËMËRTËVLERAVE!



KOLEGJI UNIVERSITAR "BEDËR"

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

GRUPI I VETËVLERËSIMIT:

1. Dr. Arti Omeri	Kryetar	Firma	
2. Dr. Valmora Gogo	Anëtare	Firma	
3. Dr. Irena Shehu	Anëtare	Firma	
4. Dr. Gentjan Skara	Anëtar	Firma	
5. Dr. Genti Kruja	Anëtar	Firma	
6. Msc. Edlir Spaho	Relator	Firma	
7. Era Tafa	Anëtare (Studente)	Firma	

Data: 20/04/2021



PËRMBAJTJA

I.	Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit	4
II.	Historiku i IAL	6
III.	Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional	8
1.	FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT	8
	Autonomia	8
	Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë	14
	Partneriteti	16
2.	FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET	21
	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	21
	Menaxhimi Financiar	25
	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit	27
	Menaxhimi i Veprimtarisë së Institucionit	30
3.	FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA	34
	Programet e Studimeve të ofruara	34
4.	FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI	47
	Organizimi i Programeve të Studimeve	47
	Kërkimi: Rezultatet e kërkimit, përhapja, vlerësimi dhe transferimi i tyre	50
5.	FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE	57
	Studentët: Nga regjistrimi deri te punësimi	57
IV.	Përfundimet dhe vlerësimi i përgjithshëm	65
V.	Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së	68
VI.	Shtojcat	72



(Handwritten signatures in blue ink)

I. Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", statutit të KU "Bedër", si dhe urdhrin të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë", nën përgjegjësinë e titullarit të institucionit, rektorit Prof. Dr. Ferdinand Gjana, u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) institucional.¹

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë në grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit.

Grupi është ngritur qëllimisht për misionin e vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja përfaqëson të dyja njësitë kryesore të kolegjit, përfshirë edhe përfaqësuesen e studentëve, ngritur duke marrë parasysh edhe shpërndarjen e detyrave të secilit anëtar.

Ky proces rivlerësimi i jashtëm institucional vjen pas përvojave të akreditimit në vitet 2013 dhe 2017, të cilat institucioni ynë i kaloi me sukses,²³ çka do të thotë që institucioni ka qenë gjithmonë i angazhuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha strukturat e tij. KU "Bedër" ka ngritur që në fillimet e tij edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si njësi e përhershme për të kontrolluar dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve në këtë drejtim.⁴

Duke filluar nga viti 2012, çdo njësi bazë dhe kryesore e KU "Bedër", dorëzon në Rektorat çdo fundviti akademik, raportin vjetor, i cili është në vetvete një model i vlerësimit të brendshëm të njëjësive.⁵ Raporti i vetëvlerësimit u diskutua në çdo njësi, nga ku dolën mendime dhe sugjerime të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar.

¹Evidenca nr.1: Vendimi i Senatit Akademik për ngritjen e grupit të punës së RVB Institucional

²Evidenca nr.2: Vendimi i Akreditimit Institucional, 2013

³Evidenca nr.3: Vendimi i Akreditimit Institucional, 2017



⁴Evidenca nr.4: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

⁵Evidenca nr.5: Shembull, Raporti vjetor të një njësie bazë



Etapat e procedurës së vlerësimit të brendshëm nga IAL:

1. Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm institucional nga ana e KU "Bedër"
2. Pranimi i kërkesës dhe njoftimi për trajnimin e grupit të punës mbi sistemin e menaxhimit të ASCAL
3. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm me vendim të Senatit Akademik të institucionit
4. Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzimeve përkatëse të ASCAL-it.
5. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), sipas kërkesave të udhëzimeve dhe më pas konsultimi i përmbajtjes së tij me personelin e institucionit.
6. Dorëzimi në ASCAL i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bashkë me të gjithë dokumentacionin mbështetës.



II. Historiku i IAL

Kolegji Universitar "Bedër" (KU "Bedër") u çel me kërkesë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe vendimit nr.286, datë 6.4.2011 të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit u miratua dhënia e licensës për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë.⁶ Ky institucion i arsimit të lartë funksionon si organizatë jofitimprurëse.⁷ KU "Bedër" synon pareshtur rritjen e cilësisë akademike dhe institucionale, e cila ka përcaktuar vizionin e funksionimit. Kapaciteti studentor maksimal afatmesëm i parashikuar i kolegjit universitar është 1000 -1300 studentë në të gjitha programet, për nivelet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë ("Bachelor", "Master"). KU "Bedër" operon mbi baza jofitimprurëse dhe mbështet studentët e suksesshëm, të cilët duan të vazhdojnë studimet e larta pranë tij. Gjatë 10 viteve të aktivitetit të tij, në KU "Bedër" janë pranuar 2380 studentë, pjesa më e madhe e të cilëve kanë përfituar zbritje nga tarifat e studimit. KU "Bedër" që nga fillimi i aktivitetit akademik ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, simpoziume, seminare të hapura, veprimtari kualifikuese e nxitëse, duke dhënë kontribut në shkencë dhe shoqëri.⁸

Për përmbushjen e misionit të tij, KU "Bedër" në vitin akademik 2019 – 2020 përfundoi me sukses procesin e riorganizimit të njësive kryesore.⁹

Programet e studimit në të dyja ciklet organizohen në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga Karta e Bolonjës dhe legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë dhe në përshtatje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit.

Programet e ofruara janë si më poshtë:

Programe profesionale dy-vjeçare:

- Multimedia dhe dizajn grafik;
- Programim në web.

Bachelor në:

- Drejtësi¹⁰;
- Shkenca komunikimi;
- Marrëdhënie publike dhe komunikim marketingu;
- Teknologji informacioni dhe komunikimi;
- Shkenca kompjuterike;

⁶Evidenca nr.6: Vendimi për liçensimin e KU "Bedër"

⁷Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", Neni 1

⁸Evidenca nr.8: Raporti Vjetor Institucional për vitin akademik 2017 – 2018

⁹Evidenca nr. 9: Urdhëri për Riorganizimin e njësive kryesore të KU "Bedër"

¹⁰ Programi "Bachelor" në Drejtësi është riorganizuar në vitin akademik 2019-2020



- Shkenca islame;
- Gjuhë dhe letërsi angleze;
- Arsim parashkollor dhe fillor;
- Psikologji këshillimi dhe pedagogji.

“Master i shkencave” në:

- Drejtësi. Profilet: e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare;
- Shkenca komunikimi. Profilet: marrëdhënie me publikun dhe gazetari;
- Shkenca moderne islame;
- Shkenca themelore islame;
- Psikologji këshillimi dhe pedagogji;
- Gjuhë dhe letërsi angleze.

“Master profesional” në:

- Mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm.
- Komunikim marketingu

Programet e integruara:

- Program i integruar i nivelit të dytë “Master i shkencave” në Drejtësi.



III. Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional

1. FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT

Autonomia

Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit

Statuti i KU "Bedër"¹¹, rregullorja themelore¹², rregullorja mbi organizimin akademik¹³, rregullorja mbi organizimin administrativ¹⁴, rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit¹⁵ si dhe rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë¹⁶, janë hartuar nga njësitë e Kolegjit në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë." dhe me aktet nënligjore në fuqi.

Rregulloret kanë si qëllim të sigurojnë kuadrin ligjor për organizimin akademik dhe administrativ të institucionit, duke garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike dhe administrative të KU "Bedër".

Të gjitha rregulloret, udhëzimet dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit janë hartuar në përputhje dhe harmoni të plotë me statutin e KU "Bedër", i cili është i miratuar edhe nga Ministria përgjegjëse për arsimin¹⁷. Të gjitha aktet e brendshme janë në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, të shprehura qartazi dhe në statutin e tij.¹⁸ KU "Bedër" është i angazhuar për përshtatjen dhe përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme të rregulloreve, udhëzimeve dhe statutit, në përputhje me kërkesat dhe propozimet e marra nga njësitë bazë, nga njësitë kryesore si dhe nga këshilli studentor, të cilat diskutohen në Senatin Akademik duke dëshmuar një tipar pozitiv të mirëfunksionimit të institucionit.

Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë efektivitet në menaxhim

Organet drejtuese ushtrojnë efektivisht menaxhimin e institucionit. Organizimi i brendshëm dhe kontrolli në institucion bëhet në përputhje me përcaktimet në statut dhe në rregulloret e brendshme. Ekzistojnë ndarje të qarta të veprimtarisë së organeve dhe autoriteteve drejtuese, personelit administrativ dhe atij akademik. Menaxhimi i institucionit realizohet në bazë të

¹¹Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër"

¹²Evidenca nr.10: Rregullorja Themelore

¹³Evidenca nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

¹⁴Evidenca nr.12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

¹⁵Evidenca nr.13: Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit

¹⁶Evidenca nr.14: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

¹⁷Evidenca nr.15: Shkresa e miratimit të statutit të KU "Bedër"

¹⁸Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër"



kompetencave të organeve drejtuese, të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e KU "Bedër", të cilat ushtrojnë në mënyrë efektive detyrat e tyre. Detyrat dhe përgjegjësitë e njësive akademike janë të përcaktuara në rregulloren për organizimin akademik¹⁹, ndërsa ato të njësive administrative përcaktohen në rregulloren e organizimit administrativ.²⁰

Në KU "Bedër" organet drejtuese janë:²¹

- Senati Akademik;
- Bordi i Administrimit;
- Rektorati;
- Dekanati;
- Asambleja e personelit akademik;
- Asambletë e personelit akademik të njësive kryesore;
- Këshilli i Etikës;
- Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin
- Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit;
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Në KU "Bedër" autoritetet drejtuese janë:²²

- Rektori;
- Dekanët;
- Përgjegjësit e departamenteve/ Drejtorët e qendrave të kërkimit;
- Zv. rektori dhe zv. dekanët;
- Administratori i Kolegjit;
- Administratorët e njësive kryesore.

Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i KU "Bedër", që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efektivitetin e tyre. Senati Akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit. Funkcionet e Senatit Akademik janë përcaktuar në nenin 9 të statutit.²³

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të


¹⁹Evidenca nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

²⁰Evidenca nr.14: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

²¹Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 8, pika 1

²²Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 8, pika 2

²³Evidenca nr. 7: Statuti i KU Bedër, neni 9, pika 1

pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij. Funkzionet e bordit të administrimit janë përcaktuar në nenin 30 të statutit.²⁴

Dekani është organ kolegjal ekzekutiv i njësisë kryesore përkatëse dhe përbëhet nga: dekani, zëvendësddekani, përgjegjësit e njësive bazë dhe administratori i njësisë kryesore. Funkzionet e dekanatit janë përcaktuar në nenin 20 të statutit.²⁵

Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore. Ajo ushtron kompetencat e përcaktuara në Rregulloren Themelore të institucionit. Funkzionet e asamblesë së personelit akademik të njësive kryesore janë përcaktuar në nenin 23 të statutit.²⁶

Këshilli i Etikës ka si funksion kryesor diskutimin e problemeve që lidhen me etikën e jetës universitare në Kolegjin Universitar "Bedër" dhe vendos rreth masave disiplinore. Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështje në lidhje me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale. Funkzionet e këshillit janë përcaktuar në nenin 25 të statutit.²⁷

Komisionet e përhershme janë organe kolegjiiale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, të cilat lidhen kryesisht me garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikën e institucionit.

NJSBC-ja është strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Funkzionet e NJSBC janë përcaktuar në nenin 29 të statutit.²⁸

Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit, si edhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Funkzionet dhe kompetencat e tij janë përcaktuar në nenin 38 të statutit.²⁹

Dekani është autoriteti drejtues në një fakultet të Kolegjit, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij. Funkzionet dhe kompetencat e tij janë përcaktuar në nenin 42 të statutit.³⁰

Përgjegjësi i departamentit / drejtori i qendrës kërkimore shkencore është autoriteti drejtues i një njësie bazë në njësitë kryesore të KU "Bedër". Funkzionet dhe kompetencat e tij janë përcaktuar

²⁴Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 30, pika 1

²⁵Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 20

²⁶Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 23

²⁷Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 25

²⁸Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 29

²⁹Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 38

³⁰Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 42



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

në nenin 46 të statutit.³¹

Zëvendësrektori është autoritet drejtues në KU "Bedër"; përzgjedhja, miratimi, emërimi, shkarkimi dhe detyrat e tij janë parashikuar në nenet 49 dhe 50 të statutit.³²

Zëvendësdekani është autoritet drejtues në njësitë kryesore pranë KU "Bedër"; emërimi, shkarkimi dhe detyrat e tij janë parashikuar në nenin 51 të statutit.³³

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të Kolegjit. Ai është përfaqësuesi ligjor i Kolegjit për çështjet financiare dhe administrative dhe harton projektbuxhetin vjetor mbi bazën e propozimeve të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë, mbështetur në "Planin strategjik" të zhvillimit të Kolegjit dhe në "Planin buxhetor afatmesëm" të tij. Projektbuxheti i hartuar kalon për diskutim në rektorat, i cili ia kalon për aprovim Senatit Akademik. Ky i fundit e dërgon për miratim përfundimtar në Bordin e Administrimit, si organi më i lartë vendimmarrës dhe që merr vendime për ndryshime të mundshme.³⁴ Planifikimi bëhet në bazë të nevojave dhe propozimeve të njësisë përkatëse, kurse shpërndarja bëhet respektivisht në njësitë në fjalë. Funkcionet dhe kompetencat e administratorit janë përcaktuar në nenin 54 të statutit.³⁵

Administratori i fakultetit (njësisë kryesore) është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të tij (fakultetit). Funkcionet dhe kompetencat e administratorit të fakultetit janë përcaktuar në nenin 56 të statutit.³⁶

Që të sigurohet efektshmëri në menaxhim, institucioni zbaton me rigorizitet planin strategjik 2018-2023, i cili përcakton në mënyrë të qartë dhe të detajuar komponentet më të rëndësishme për funksionimin me rendiment të institucionit.³⁷

Institucioni favorizon debatin konstruktiv

Institucioni karakterizohet nga debati konstruktiv në vendimmarrje në të gjitha njësitë përbërëse. Në bazë të procedurave të brendshme të KU "Bedër", rendi i ditës së bashku me dokumentacionin përkatës, vihen në dispozicion të anëtarëve të organeve kolegjiale, para mbledhjes në fjalë. Procedurat e mbledhjeve për njësi dhe organe kolegjiale të ndryshme përcaktohen në statutin e institucionit dhe në rregulloret përkatëse. Kalendari i mbledhjeve miratohet në fillim të çdo viti nga organet kolegjiale respektive.³⁸ Rregulloret e brendshme

³¹Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 46

³²Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, nenet 49-50

³³ Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 51


³⁴Evidenca nr.16: Praktika e miratimit të buxhetit

³⁵ Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 54

³⁶ Evidenca nr.7: Statuti i KU Bedër, neni 56

³⁷Evidenca nr.17: Plani Strategjik Institucional 2018-2023

³⁸Evidenca nr. 18: Shembull, Kalendari i mbledhjeve të senatit

përcaktojnë në mënyrë të qartë përgjegjësitë dhe detyrat e senatit, si dhe të organeve të tjera kolegjiale, të cilat në shumicën e rasteve kanë fuqi vendimmarrëse dhe jo vetëm propozuese. Senati dhe ekipet drejtuese mbledhen në mënyrë periodike, në përputhje me rregulloret përkatëse.

Duke synuar mbarëvajtjen e plotë të proceseve këshillimore dhe vendimmarrëse, si edhe ndjekjen dhe zbatimin e vendimeve, institucioni ndjek procedura të përcaktuara për organizimin e mbledhjeve të njëjësive të ndryshme.³⁹

Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij

KU "Bedër" gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit. Secila prej këtyre lirive është e përshkruar në mënyrë të detajuar në nenin e dytë të statutit.⁴⁰

Menaxhimi, vlerësimi akademik dhe administrativ, zhvillimi i cilësisë dhe vlerësimi i jashtëm realizohet nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë⁴¹, që është organi përgjegjës për vëzhgimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra, kontrollin periodik dhe përmbushjen e sugjerimeve të bëra.⁴²

Institucioni mban të ngritura dy komisione të përhershme: Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin⁴³ dhe Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.⁴⁴ NJSBC ka bërë pjesë integrale të organizimit dhe funksionimit të saj standardet e vendosura nga organizma, të cilat garantojnë cilësinë duke marrë në konsideratë parashikimet dhe detyrimet që lindin nga Karta e Bolonjës dhe legjislacioni në fuqi. Në mbështetje të mirëfunksionimit të NJSBC, Senati⁴⁵ vendos një ekspert të jashtëm pranë njësisë dhe komisionit⁴⁶, që përzgjedhet në bazë të eksperiencës në fushën akademike dhe njohjes së sistemit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, misionin e tij dhe objektivat e përcaktuara në planin strategjik, një nga synimet e KU "Bedër" është tërheqja e financimeve nga programet evropiane dhe me gjerë.⁴⁷ Për përmbushjen e këtij

³⁹Evidenca nr. 19: Praktika për organizimin e mbledhjeve të njëjësive

⁴⁰Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 2

⁴¹Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 28-29

⁴²Evidenca nr.4: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

⁴³Evidenca nr. 20: Vendimi për ngritjen e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin

⁴⁴Evidenca nr. 21: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit

⁴⁵Evidenca nr. 22: Vendime senati për emërimet e ekspertit të jashtëm në njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë

⁴⁶Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 28

⁴⁷Evidenca nr.17: Plani strategjik institucional 2018-2023



(Handwritten signatures in blue ink)

objektivi, në institucion janë ngritur dhe funksionojnë dy zyra, përkatësisht zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe zyra e Kërkimit Shkencor, të cilat janë të organizuara në mënyrë që të mbështesin dhe të lehtësojnë përfitimin e fondeve nga programet e BE-së dhe më gjerë. Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare (IRO)⁴⁸ ka në përbërje të saj koordinatorin për programin Erasmus+, që mundëson marrjen dhe shpërndarjen e informacionit lidhur me projektet dhe procedurat e aplikimit. Zyra e kërkimit shkencor⁴⁹ shërben si organ që mbështet personelin akademik lidhur me informacionin mbi thirrjet e hapura për projekte dhe financime, si dhe aspektet teknike të procedurave të aplikimit.^{50 51}

Institucioni harton një strategji zhvillimi

Senati i KU "Bedër", pas diskutimesh në plan të gjerë me të gjitha njësitë, ka miratuar Planin Strategjik 5-vjeçar të institucionit.⁵² Pas vlerësimit të procesit të mbarëvajtjes dhe përcaktimit të detyrave, grupi e punës për hartimin e planit strategjik nisi takimet e punës në qershor të vitit 2017, duke përcaktuar atë si sfidë primare të institucionit.⁵³

Në këtë këndvështrim, plani strategjik, në përmbushje të misionit të institucionit, synon zhvillimin në këto drejtime kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri.

Disa nga objektivat e këtij plani janë:

- Sigurimi i një arsimit cilësor që promovon nëpërmjet vlerësimit mendimin kritik dhe përgatitjen e studentëve për identifikimin, ndërtimin dhe vlerësimin e argumenteve;
- Sigurimi i një cilësie arsimore që i pajis studentët me aftësi praktike për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës;
- Rritja e mundësive dhe përvojave ndërkombëtare për studentët;
- Nxitja dhe mbështetja e pjesëmarrjes aktive të personelit akademik dhe studentëve të programit "Bachelor" dhe "Master" në projekte dhe veprimtari kërkimore-shkencore;
- Mbështetja e inovacionit dhe ideve që ndikojnë në nxitjen e zhvillimit të shoqërisë dhe rritjen e ndikimit ndërkombëtar të institucionit;
- Rritja e cilësisë së pranimit nëpërmjet tërheqjes dhe diplomimit të një trupe cilësore e të larmishme studentësh;
- Rritja e promovimit të institucionit dhe e programeve të studimit me qëllim tërheqjen

⁴⁸Evidenca nr. 11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, neni 23


⁴⁹Evidenca nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, neni 21-22

⁵⁰Evidenca nr. 16: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore

⁵¹Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 87

⁵²Evidenca nr. 24: Vendim i senatit për miratimin e planit strategjik institucional 2018-2023

⁵³Evidenca nr. 25: Urdhrat e Rektorit për ngritjen e grupit dhe nëngrupeve të punës për hartimin e planit strategjik institucional 2018-2023

e studentëve më të mirë;

- Rritja e mbështetjes së studentëve nga strukturat institucionale në veprimtarinë akademike dhe aftësimin për tregun e punës;
- Mbështetja e klubeve studentore dhe veprimtarive sociale, kulturore e sportive për të siguruar një eksperiencë sa më të plotë të jetës studentore;
- Ruajtja e një marrëdhënieje të konsoliduar dhe në vijim me studentët e diplomuar, nëpërmjet bashkëpunimit, zhvillimit të rrjeteve profesionale, marrëdhënies së mbikëqyrjes dhe pjesëmarrjes në aktivitete që përkrahin interesat dhe vlerat e institucionit;
- Mbështetja e praktikave më të mira të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, të menaxhimit institucional dhe të marrëdhënieve me komunitetin.⁵⁴

Plani strategjik ka përcaktuar objektiva të qarta si dhe strategjitë e instrumentet përkatëse për arritjen e tyre, duke u miratuar edhe nga Bordi i Administrimit.⁵⁵ Strategjia e institucionit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e KU "Bedër".⁵⁶

Institucioni publikon raportin vjetor, e paraqet atë pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe para personelit akademik e studentëve

Në fund të vitit akademik, KU "Bedër" përgatit Raportin Vjetor të Aktiviteteve⁵⁷ dhe Raportin Vjetor Institucional.⁵⁸ Një kopje e raportit i dorëzohet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Raporti i plotë institucional bëhet publik edhe nëpërmjet faqes së internetit (<http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=9>).^{36.} Çdo anëtar i personelit akademik të KU "Bedër", njihet me raportin në fjalë. Duke analizuar punën e një viti, raporti ndihmon për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Ai merret si bazë për përmirësimin e cilësisë, si një tregues i transparencës institucionale dhe i rritjes së besueshmërisë nga palët e treta. Raporti i aktiviteteve vihet në dispozicion të organeve kolegjiale të KU "Bedër" dhe publikohet në faqen e internetit të institucionit.

Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë

Institucioni ngre struktura të përshtatshme për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij

Misioni i Kolegjit Universitar "Bedër" është përgatitja e individëve të kualifikuar nëpërmjet

⁵⁴Evidenca nr. 17: Plani strategjik institucional 2018-2023

⁵⁵Evidenca nr. 26: Vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin e planit strategjik institucional 2018-2023

⁵⁶Evidenca nr. 17: Plani strategjik institucional 2018-2023

⁵⁷Evidenca nr. 27: Shembull i Raportit të aktiviteteve të një njësie bazë

⁵⁸Evidenca nr. 8: Raporti Vjetor Institucional për vitin akademik 2017 - 2018







një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Vizioni i KU "Bedër" është që të jetë një institucion elitari i arsimit të lartë në vend dhe rajon dhe për të qenë alternativë e parë e edukimit dhe kërkimit shkencor për shqiptarët kudo që ndodhen. Autonomia dhe liria akademike janë elemente kyç, të cilat ndihmojnë në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit. Liria akademike parashikohet në nenin 2 të statutit të institucionit.⁵⁹ Personeli akademik i KU "Bedër" gëzon liri akademike në procesin mësimor dhe në kërkimet shkencore në kuptimin e ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". KU "Bedër" vlerëson mbështetjen e kërkimit shkencor⁶⁰, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë. Në ushtrimin e lirisë akademike, personeli i KU "Bedër" duhet të mbajë një qëndrim të ndershëm dhe të përgjegjshëm, për t'i dhënë komunitetit shkencor dhe shoqërisë metodologjinë, rezultatet, përplotësimin dhe ndikimin etik të kërkimeve. Sipas udhëzimit mbi nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor, institucioni mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen arritjet akademike vjetore mbi të dhëna transparente, të parashikuara në udhëzimin përkatës.^{61 62}

KU "Bedër" ka në përbërjen e tij dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë si dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit. Struktura e brendshme e të dy fakulteteve ka 7 njësi bazë përbërëse^{63 64} nga të cilat 6 janë departamente dhe Qendrën Kërkimore për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion. Bashkangjiten me to edhe njësitë administrative, sipas organigramës së miratuar.^{65 66} Njësitë e lartpërmendura operojnë në bazë të parimit të autonomisë brenda kompetencave të tyre. KU "Bedër" ofron programe studimi në dy cikle: cikli i parë i studimeve "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve "Master i shkencave" dhe "Master profesional" si dhe programe profesionale dy-vjeçare. KU "Bedër" gëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë, si Kolegji Universitar, i licensuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.286, datë 6.4.2011. Dëshmohet se KU "Bedër" ka zhvilluar konferenca të ndryshme shkencore si dhe ka publikime të shumta realizuar prej personelit akademik.

⁵⁹Evidenca nr. 7: Statuti i KU "Bedër", neni 2

⁶⁰Evidenca nr. 23: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore

⁶¹ Evidenca nr. 28: Udhëzim mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor

⁶²Evidenca nr. 29: Procedura e mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca

⁶³Evidenca nr. 13: Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, neni 4

⁶⁴Evidenca nr. 14: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, neni 4

⁶⁵Evidenca nr. 30: Organigrama e KU "Bedër"

⁶⁶Evidenca nr. 31: Organigrama e Fakulteteve të KU "Bedër"



Pikësynimi ka qenë kërkimi shkencor i zbatuar. Departamentet kanë në përbërje të tyre, të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët, të paktën, 3 janë me grada shkencore dhe tituj akademikë.⁶⁷ Institucioni ka faqen e vet zyrtare të internetit, e cila mundësohet në adresën: www.beder.edu.al

Organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat e institucionit

Në drejtim të institucionit janë: Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Në drejtim të njësive kryesore është dekanati dhe në drejtim të njësive bazë të departamentit funksionon këshilli i departamentit. Informacion më i detajuar për kompetencat dhe funksionet e këshillave në fjalë gjenden në nenet respektive në statut, në rregulloren themelore⁶⁸, në rregulloren për organizimin akademik⁶⁹ dhe në rregulloren për organizimin administrativ⁷⁰, që përcaktojnë mënyrën e mbledhjes dhe vendimmarrjes në organet kolegjiale.

KU "Bedër" vlerëson diskutimin me bazë të gjerë pjesëmarrjeje. Kompetencat e parashikuara në statut⁷¹ dhe në rregulloret respektive tregojnë qartë aftësinë e këshillave të departamentit, këshillave studentor dhe asambleve të personelit akademik të njësive kryesore për të dhënë mendime dhe propozime, si edhe për të marrë vendime. Në bazë të procedurës së vendimmarrjes, pasi bëhet zbardhja e vendimeve të marra nga këshillat respektive, bëhet komunikimi në mënyrë shkresore ndaj njësive që preken nga vendimi në fjalë, kurse disa vendime u dërgohen me e-mail në formë të skanuar personave dhe njësive që preken. Në këtë mënyrë, në bazë të parimit të hierarkisë institucionale, personeli akademik dhe administrativ përfshihen në debatin e brendshëm.

Partneriteti

Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.

Institucioni ka kryer studime tregu për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. Ai realizon studimin e tregut për njësitë kryesore, bazë si dhe për programet e reja me të cilat parashikon të zgjerohet.⁷² KU "Bedër" merr parasysh sugjerimet e studimeve të tregut të punës të organizuara nga departamentet për programet respektive. Nisur nga sugjerimet e bëra në studimet e tregut nga departamentet përkatëse, janë propozuar edhe ndryshime në kurrikulën e disa programeve në proces riorganizimi, apo edhe për programe të reja. Një ndër objektivat

⁶⁷Evidenca nr. 32: Lista e stafit akademik për çdo departament me gradat përkatëse

⁶⁸Evidenca nr. 10: Rregullorja themelore

⁶⁹Evidenca nr. 11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

⁷⁰Evidenca nr. 12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

⁷¹Evidenca nr. 7: Statuti i KU Bedër

⁷²Evidenca nr. 33: Shembull studim tregu



(Handwritten signatures and initials)

e paraqitura në Planin Strategjik është përditësimi i programeve mësimore dhe kërkimi shkencor sipas nevojave të tregut.⁷³

Monitorimi i zhvillimeve për arsimin e lartë nga zyra e medias, i dërgohet në mënyrë periodike rektoratit, i cili analizon të dhënat dhe në rast nevoje, bën sugjerimet dhe përshtatjet e nevojshme në planin strategjik.⁷⁴ Këto të dhëna mblidhen nga grupet e krijuara, workshopet dhe tryezat e rumbullakëta me specialistë të fushave dhe përfaqësues të IAL-ve, të cilët ofrojnë programe të ngjashme studimi. KU "Bedër" aktualisht ka 1310 të diplomuar gjithsej.⁷⁵ Në strukturat e dekanit të studentëve funksionon zyra e të diplomuarëve, si dhe ajo e planifikimit të karrierës. Funksionimi i kësaj njësie dhe vëzhgimi i të diplomuarëve parashikohet në rregulloren e organizimit administrativ.⁷⁶ Për të mbështetur të diplomuarit, KU "Bedër" vlerëson të rëndësishëm bashkëpunimin me institucione, kompani publike dhe private për punësimin e tyre⁷⁷. Duke u bazuar në moton institucionale "Në emër të vlerave", gjatë fushatave reklamuese dhe zhvillimit të aktivitetit akademik, KU "Bedër" i kushton një rëndësi të veçantë dhe zbaton me përpikmëri rregullat e konkurrencës, vlerëson punën e institucioneve homologe, duke ofruar jo rrallë edhe mundësi bashkëpunimi në organizime shkencore.⁷⁸

Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar

KU "Bedër" ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij. KU "Bedër" ndjek një politikë favorizuese me institucionet e huaja arsimore, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e përbashkët të konferencave dhe projekteve, si edhe trajnimet profesionale dhe praktikat studentore. Aktualisht institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rreth 65 institucione, mes të cilave universitete, bashki, institucione publike dhe private.⁷⁹ Strategjia për bashkëpunimet e mundshme pasqyrohet dhe në strategjinë afatgjatë të zhvillimit të institucionit.

Institucioni ndjek një strategji bashkëpunimi me institucionet të tjera mbështetëse

KU "Bedër" bashkëpunon me institucione të tjera për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve. Këto shërbime ofrohen në bazë të nevojave, si ato shëndetësore, profesionale etj. Në kuadër

⁷³Evidenca nr. 17: Plani strategjik institucional 2018-2023

⁷⁴Evidenca nr. 12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ, neni 37, pika 12

⁷⁵Evidenca nr. 34: Të diplomuarit ndër vite

⁷⁶Evidenca nr. 12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ, neni 40-44

⁷⁷Evidenca nr. 35: Statistika mbi punësimin e të diplomuarve

⁷⁸Evidenca nr. 36: Shembull marrëveshje bashkëpunimi me një institucion të arsimit të lartë

⁷⁹Evidenca nr. 37: Lista e institucioneve partnere






të plotësimit të nevojave të veta për funksionimin e programeve të studimeve, KU "Bedër" ka nënshkruar disa marrëveshje me institucione të ndryshme.⁸⁰ Prej institucioneve kryesore mbështetëse mund të përmendim: KMSH, mediet, Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë dhe rrjetin e medreseve të vendit. Rëndësi të veçantë kanë edhe marrëveshjet e nënshkruara për realizimin e praktikave të ndryshme profesionale.⁸¹

Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për lëvizshmërinë (mobilitetin) e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar. Ai ka marrëveshje mobiliteti me institucione në Kroaci dhe Rumani në kuadër të programit Erasmus+.⁸²

Për tre vjet rresht lektorë dhe studentë të KU "Bedër" kanë marrë pjesë në programin SUSI në SHBA të organizuar nga Departamenti i Shtetit.⁸³

KU "Bedër" ndër vite ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Anëtarë të personelit akademik të KU "Bedër" kanë marrë pjesë në veprimtari të rëndësishme jashtë vendit. Me institucionet arsimore të huaja, me të cilat KU "Bedër" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e konferencave ndërkombëtare, të projekteve të përbashkëta kërkimore dhe të trajnimeve profesionale⁸⁴, si dhe praktikave studentore.⁸⁵

Duke synuar të ndjekë një politikë integruese për personelin akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj, KU "Bedër" ka punësuar pedagogë të huaj nga shtete të ndryshme të botës, si: SHBA, Kosova, Britania e Madhe dhe Jordania. Një pjesë e pedagogëve të ftuar kanë ardhur në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të ndryshme.

Institucioni në kuadër të integritit të studentëve të huaj dhe për të lehtësuar procedurat dhe vështirësi të ndryshme që mund të dalin, ka hartur politikën e vet specifike⁸⁶.

⁸⁰Evidenca nr. 37: Lista e institucioneve partnere

⁸¹Evidenca nr. 38: Shembull marrëveshje për praktikat profesionale

⁸²Evidenca nr. 39: Marrëveshje mobiliteti Erasmus +

⁸³Evidenca nr. 40: Model Certificate pjesëmarrje - SUSI

⁸⁴Evidenca nr. 41: Konkursët ndërkombëtare të departamentit të drejtësisë

⁸⁵Evidenca nr. 42: Raste praktike shkëmbimi studentësh dhe stafi

⁸⁶Evidenca nr. 43: Politika për studentët e huaj



(Handwritten signatures and marks)

Përfundimet dhe Vlerësimi

Grupi i vlerësimit të brendshëm për fushën e vlerësimit "Organizimi dhe menaxhimi i institucionit" konstaton se **standardet janë përmbushur plotësisht.**

Institucioni dëshmon me fakte se funksionon në përputhje me parashikimin e statutit dhe rregulloreve të tij të brendshme. Struktura e brendshme dhe mënyra e funksionimit siguron autonominë akademike, financiare dhe organizative, si dhe ka realizuar me sukses ndërkombëtarizimin e aktivitetit të tij mësimor dhe shkencor, përmes marrëveshjeve me institucione të tjera, brenda e jashtë vendit. Vendimmarrja realizohet nga organet kolegjiale, të ngritura sipas legjislacionit, të cilat garantojnë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të institucionit dhe objektivitet e transparencë në këtë proces.

Si institucion i arsimit të lartë karakterizohet nga debati konstruktiv në vendimmarrje në të gjitha njësitë përbërëse.

KU "Bedër" gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit.

Senati i KU "Bedër", pas diskutimesh në plan të gjerë me të gjitha njësitë, ka miratuar planin strategjik 5-vjeçar të institucionit. Në të përcaktohen objektiva të qarta, si dhe strategjitë dhe instrumentet përkatëse për arritjen e tyre.

Institucioni publikon raportin vjetor, e paraqet atë pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe para personelit akademik e studentëve. Ai merret si bazë për përmirësimin e cilësisë, si një tregues i transparencës institucionale dhe i rritjes së besueshmërisë nga palët e treta.

Institucioni ka në përbërjen e tij struktura të përshtatshme për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. Autonomia dhe liria akademike e strukturave të tij janë elemente kyç, të cilat ndihmojnë në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit.

KU "Bedër" vlerëson diskutimin me bazë të gjerë pjesëmarrjeje, në këtë kuadër organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat e institucionit.

Institucioni kryen studime tregu për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij. Ai kryen studimin e tregut për njësitë kryesore, bazë si dhe për programet e reja me të cilat parashikon të zgjerohet.

KU "Bedër" ndjek një strategji të qartë për bashkëpunimin në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij dhe një politikë favorizuese me institucionet e huaja arsimore, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e përbashkët të

konferencave dhe projekteve, si edhe trajnimet profesionale dhe praktikat studentore.

Në kuadër të programit Erasmus+, institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar dhe për këtë qëllim ka bërë marrëveshje mobiliteti me institucione në Kroaci dhe Rumani.





2. FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore

KU "Bedër" ka një strukturë organizative të mirërregulluar sipas ligjeve në fuqi dhe gjithmonë është treguar transparent në bërjen publike të mënyrës së organizimit të institucionit, duke publikuar në faqen e internetit organigramën⁸⁷, si edhe duke ia paraqitur atë pas çdo ndryshimi të bërë, ministrisë përkatëse.

Institucioni publikon kriteret e punësimit për çdo vend të lirë pune bazuar në procedurën e punësimit, ku tregohen hapat për shpalljen e vendeve të lira të punës dhe kriteret e punësimit. Procedura^{88 89} ndiqet duke kaluar në disa hallka; ajo fillon nga njësia bazë dhe vazhdon më pas në dekanat, rektorat, deri në zyrën e burimeve njerëzore, e cila bën dhe shpalljen në websitin⁹⁰ zyrtar. Shpallja për vende të lira publikohet edhe në rrjetet sociale të universitetit. Për punësimin e personelit akademik dhe personelit administrativ, veprohet në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve të tjera nënligjore të dala për zbatimin e tij. KU "Bedër", në varësi të nevojave të evidentuara nga njësiti bazë, ka punësuar personel ndihmës mësimor-shkencor, por në kuadër të ndihmës së nevojshme për njësiti, ka punësuar edhe personel administrativ. Institucioni rekruton me përparësi personel akademik të kualifikuar në universitete të njohura në shkallë ndërkombëtare. KU "Bedër" ka për qëllim rekrutimin⁹¹ e personelit akademik të kualifikuar në bazë të fushave specifike të programeve të studimit. Gjithashtu, i është dhënë përparësi rekrutimit të personelit akademik të diplomuar në universitete me zë brenda dhe jashtë vendit. Një pjesë e mirë e personelit kanë kryer të paktën një cikël studimi në një universitet jashtë vendit, diploma e të cilëve është e njehsuar në MASR. Aplikantët pasi janë njohur me vendet e lira të punës dhe e shohin veten si kandidatë të mundshëm, dërgojnë CV e tyre pranë zyrës së Burimeve Njerëzore me anë të postës elektronike⁹².

Institucioni ndjek gjithashtu një politikë për promovimin⁹³ e personelit akademik me kohë

⁸⁷Evidenca nr.30: Organigrama e KU "Bedër"

⁸⁸Evidenca nr.44: Procedura e rekrutimit të stafit akademik

⁸⁹Evidenca nr.45: Procedura e rekrutimit të stafit administrativ

⁹⁰Evidenca nr.46: Shembull i linkut për publikimin e vendeve të lira të punës

⁹¹Evidenca nr. 44: Procedura e rekrutimit të stafit akademik

⁹²Evidenca nr. 47: Adresa e emailit zyrtar të zyrës së burimeve njerëzore, hr@beder.edu.al

⁹³Evidenca nr.48: Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik







të plotë dhe personelit akademik me kohë të pjesshme, të ftuar apo me kontratë në bazë të rregullores së punësimit dhe promovimit.

Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ

Institucioni angazhohet në zbatimin e politikave integruese të personelit të tij. KU "Bedër" kujdeset për një mjedis integruar dhe gjithëpërfshirës të personelit akademik dhe administrativ. Prezantimi me institucionin dhe përditësimi i çdo informacioni bëhet çdo fillimviti akademik⁹⁴, duke përfshirë këtu stafin e ri dhe atë aktual. Në ciklin e takimeve orientuese, lidhur me aktivitetet dhe planifikimet vjetore marrin pjesë të gjithë anëtarët e stafit të KU "Bedër". Në kuadër të informimit të stafit është përgatitur edhe udhëzuesi (guida) e stafit⁹⁵ nga zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo guidë përditësohet çdo herë, kur ka ndryshime të nevojshme lidhur me informacionet në brendësi të saj. Integrimi i personelit ndërlidhet ngushtë edhe me studentët, ku KU "Bedër" angazhon personelin e tij për të organizuar ditët e orientimit për studentët e rinj, duke u prezantuar funksionimin e zyrave akademike dhe administrative. Gjatë këtyre ditëve studentëve u prezantohet edhe kurrikula e programit të studimit, Guida e Studentit⁹⁶, si dhe këshilltari i tyre akademik. Stafi angazhohet gjithashtu në prezantimin e aktiviteteve të institucionit pranë shkollave të mesme në rang vendi, gjatë ditëve të përcaktuara nga MASR për promovimin e institucionit. KU "Bedër" ndjek po ashtu një politikë favorizuese për personelin e tij akademik dhe integrimin në jetën sociale, duke organizuar aktivitete gjithëpërfshirëse, siç janë aktivitetet me karakter social, trajnimet⁹⁷, shëtitjet, vizitat etj., të cilat koordinohen nga njësitë e ndryshme, sipas karakterit të aktivitetit me qëllim socializimin dhe motivimin e stafit.

Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij

Institucioni ndjek një plan trajnimi sipas përparësive, ku zyra e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me NJSBC, sipas nevojave të evidentuara nga kërkesat e ardhura nga ana e stafit, projektojnë tematikat e nevojshme për trajnime gjatë vitit akademik. KU "Bedër" ndjek një politikë mbështetëse për stafin akademik, duke vlerësuar kategoritë "Asistent lektor", "Lektor" dhe "Profesor". Kjo kategori, me miratim të njësisë bazë, ku edhe zhvillojnë veprimtarinë akademike, kanë të drejtën që një herë në shtatë vite të shkëputen nga angazhimet e institucionit, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për

⁹⁴Evidenca nr.49: Programi i ditëve të orientimit, viti akademik 2019-2020

⁹⁵Evidenca nr.50: Guida e stafit

⁹⁶Evidenca nr.51: Guida e studentit

⁹⁷Evidenca nr.52: Lista e trajnimeve të stafit, viti akademik 2019-2020



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

përparimin e tyre akademik. Mënyra e rregullimit të marrëdhënieve juridike ndërmjet palëve për këtë periudhë përcaktohet në statutin⁹⁸ e institucionit të arsimit të lartë.⁹⁹ KU "Bedër" i ka vlerësuar arritjet e stafit akademik, duke i promovuar një pjesë të tyre pas fitimit të gradave në poste drejtuese, si p.sh. përgjegjës departamenti.¹⁰⁰ Gjithashtu stafi akademik në fillim të çdo viti akademik plotëson formularin e vetëvlerësimit¹⁰¹, ku parashikon aktivitetet akademike të tij për gjatë gjithë vitit akademik. Duke qenë se KU "Bedër" gëzon statusin e Kolegjit Universitar, ai nuk mund të japë gradën shkencore "Doktor i shkencave", apo tituj akademikë si "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", por mbështet dhe inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik, që të punojnë për të plotësuar të gjitha kriteret dhe të ndjekin procedurat për promovimin e tyre të mëtejshëm akademik¹⁰².

Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social

Institucioni ndjek një politikë të zhvillimit social dhe është promovues i mbështetjes dhe organizimit të një sërë aktiviteteve në këtë fushë. Zyra e Dekanit të Studentëve në KU "Bedër", në kuadër të ndërgjegjësimit të studentëve për integrimin në jetën sociale dhe kulturore të institucionit, organizon prej vitesh panairin e klubeve studentore (Bedër Club Fair)¹⁰³. Institucioni gjithashtu favorizon dialogun social, si dhe ndjek një politikë të sigurimit të jetës dhe shëndetit. Kjo e fundit u theksua sidomos gjatë kohës së pandemisë, në lehtësirat e krijuara të ndjekjes së një pjese të punëve institucionale dhe mësimdhënies në versionin online dhe së fundmi, në angazhimin për vaksinimin e të gjithë stafit në mënyrë vullnetare në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale. KU "Bedër" nëpërmjet klubeve studentore synon zgjerimin e kulturës së përgjithshme, atë juridike, politike, administrative, sociale, edukative, arsimore, psikologjike, etj. Klubet organizojnë aktivitete, që lidhen me diskutime të hapura të tematikave të ndryshme të problemeve sociale, psikologjisë së zhvillimit dhe psikologjisë klinike, zhvillimin e terapive të grupit, si dhe të aktiviteteve sportive. Ata kanë ndërmarrë gjithashtu edhe aktivitete në ndihmë të fëmijëve të ngjuar, duke organizuar fushata të ndryshme, që kanë konsistuar në ndarjen e fondeve dhe artikujve të ndryshëm shkollorë për fëmijët e ngjuar, si pasojë e fenomenit të gjakmarrjes.

Krahas këtyre, Dekani i Studentëve në bashkëpunim me zyrën e Planifikimit të Karrierës,

⁹⁸Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër"

⁹⁹Evidenca nr.53: Shembull, kërkesë leje për përparimin akademik, Dr. Gentjan Skara

¹⁰⁰Evidenca nr.54: Shembull, emërimi i Dr. Arti Omerit.

¹⁰¹Evidenca nr.55: Formulari i vetëvlerësimit të stafit

¹⁰²Evidenca nr.48: Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik

¹⁰³Evidenca nr.56: Lista e Klubeve Studentore






zyrën e Koordinimit të Klubeve Studentore, zyrën e të Diplomuarëve, si dhe zyrën e Shërbimit Psiko-Social dhe Shëndetësor, të cilat kujdesen për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me KU "Bedër", koordinojnë aktivitetet socio-kulturore të studentëve dhe janë të angazhuar në zgjidhjen e problemeve të studentëve në lidhje me jetën universitare, në bashkëpunim me njësitë administrative dhe akademike. Ato ndihmojnë në koordinimin e lidhjeve mes njësive akademike dhe administrative për çështjet që prekin drejtpërdrejt interesat e studentëve, vlerësojnë dhe drejtojnë aplikimet akademike, sociale, profesionale dhe administrative të studentëve në lidhje me jetën në mjediset universitare; organizojnë veprimtari për të rritur cilësinë e jetesës në fusha të tilla si strehimi, transporti dhe atë të aktiviteteve sociale në mjediset universitare, si dhe ofrojnë mbështetje për të siguruar një ambient edukimi efikas.

Integrimi i suksesshëm i studentëve të huaj është një element tjetër thelbësor i përmbushjes së misionit të institucionit. Procesi i integritit realizohet përmes mbështetjes aktive të njësive akademike dhe administrative, krijimit të një klime akademike, që njeh dhe reflekton vlerat e gjithëpërfshirjes, si dhe angazhimit të përbashkët të të gjitha palëve të përfshira në këtë proces. Objektivat kryesorë të politikave të integritit të studentëve të huaj janë:

- Familjarizimi i studentëve dhe i stafit të huaj me KU "Bedër";
- Lehtësimi i përshtatjes së studentëve të huaj në Republikën e Shqipërisë;
- Njohja me gjuhën, historinë dhe institucionet vendase;
- Nxitja e mundësive dhe e pjesëmarrjes së studentëve dhe stafit të huaj në aktivitetet kulturore;
- Ndërgjegjësimi i stafit dhe studentëve në KU "Bedër", me qëllim reduktimin e paragjykit social ndaj studentëve dhe stafit të huaj.

Institucioni nëpërmjet veprimtarive të orientimit ndjek politika mbështetëse për studentët. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e këshilltarit akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore.

Institucioni çdo vit të ri akademik zhvillon një takim, ku bën dhe prezantimin e punonjësve të rinj në KU "Bedër".

Institucioni siguron menaxhimin efikas të burimeve njerëzore

KU "Bedër" zbaton rregulla të qarta për caktimin e përgjegjësive sipas funksioneve respektive¹⁰⁴. Me qëllim menaxhimin efikas të aktivitetit, institucioni, përmes rregullores

¹⁰⁴Evidenca nr.30: Organigrama e KU "Bedër"



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

së organizimit akademik¹⁰⁵ dhe rregullores së organizimit administrativ të institucionit¹⁰⁶, ka përcaktuar qartë funksionet dhe detyrat e organeve akademike dhe administrative. Gjithashtu, institucioni ka hartuar për çdo pozicion përshkrimet përkatëse të punës, të cilat bëhen të ditura në njoftimin për vendin e lirë, si edhe në momentin e punësimit. Personeli akademik në aneksin e kontratës së punës¹⁰⁷ ka të shkruar në mënyrë përshkruese detyrat e veta.

Për të siguruar organizimin sa më efektiv të personelit akademik, ndarja e ngarkesës realizohet në përputhje me udhëzimin¹⁰⁸ mbi ngarkesën mësimore¹⁰⁹.

Menaxhimi Financiar

Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara

KU "Bedër" gëzon status jofitimprurës dhe jopublik. Në ndjekjen e standardeve të programimit buxhetor dhe menaxhimit financiar, institucioni ka vendosur standardet e tij të brendshme. Projektbuxheti i KU "Bedër" hartohet nga zyra e financës në bashkëpunim me administratorin e institucionit. Çdo fillim viti akademik njësitë bazë hartojnë projektbuxhetet e tyre dhe i dërgojnë ato për miratim te njësitë kryesore. Njësitë kryesore, duke marrë parasysh kërkesat e njërive bazë, hartojnë një projektbuxhet¹¹⁰ të cilin e kalojnë në mbledhjen e dekanatit. Pasi diskutohet te ky i fundit, me nënshkrimin e dekanit respektiv, i përcillet rektoratit për miratim. Duke u mbështetur te kërkesat e fakulteteve për shpenzime të tjera, përfshirë kërkesat e zyrave administrative, bazuar në buxhetet e realizuara të dy viteve të fundit, hartohet plani buxhetor njëvjeçar dhe ai afatmesëm. Projektbuxheti i hartuar i kalon për aprovim Senatit Akademik. Ky i fundit e dërgon për miratim përfundimtar në Bordin e Administrimit, si organi më i lartë vendimmarrës dhe që vendos për ndryshime të mundshme.

Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare

Menaxhimi i shpërndarjes së burimeve financiare bëhet sipas një buxheti paraprak të miratuar dhe pranuar nga të gjitha njësitë. Institucioni ka ngritur zyrën e Financës dhe Çështjeve Administrative për menaxhimin financiar të tij. Institucioni respekton standardet kombëtare të kontabilitetit dhe mirëmban regjistrimet e tij në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". KU "Bedër" është institucion jopublik i arsimit të lartë dhe rregullat e administrimit të brendshëm

¹⁰⁵Evidenca nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

¹⁰⁶Evidenca nr.12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

¹⁰⁷Evidenca nr.57: Model Kontrate me Stafin Akademik

¹⁰⁸Evidenca nr.58: Udhëzimi mbi ngarkesën mësimore

¹⁰⁹Evidenca nr.59: Shembull i ngarkesës mësimore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit

¹¹⁰Evidenca nr.60: Projektbuxheti i Fakultetit



Handwritten signatures and initials in blue ink at the bottom of the page. One signature includes the number '25'.

përcaktohen sipas akteve të miratuara nga vetë institucioni, konform edhe akteve ligjore në fuqi.¹¹¹ Mënyra e ndarjes dhe ndjekjes së buxhetit parashikohet në statutin e institucionit, i cili analizon treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare.

Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar

Raportet financiare¹¹² hartohen sipas legjislacionit në fuqi nga fondacioni, pjesë e të cilit është KU "Bedër", brenda afateve të përcaktuara, ku përfshihen pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve. Këto raporte arkivohen çdo vit pranë drejtorisë përkatëse. KU "Bedër" i paraqet çdo fundviti akademik Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar¹¹³, projektbuxheti i vitit të ardhshëm akademik, si dhe projektbuxheti afatmesëm. Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KU "Bedër" bëhet në bazë të një programi financiar, të hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit, raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, në Ligjin Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre. Në raport paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj. Raporti përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të mbarëvajtjes institucionale.¹¹⁴

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

KU "Bedër" është institucion privat jofitimprurës. Pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit, rreth 61-70%, vijnë nga pagesat e studentëve, 23%-29% nga donacionet dhe rreth 8-14% nga konsulenca dhe shërbime. Institucioni ka të drejtë të pranojë mbështetje financiare dhe materiale, që lidhen me objektin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Institucionet e Arsimit të Lartë i nënshtrohen auditit financiar, që realizohet nga institucionet e parashikuara me ligj për këtë qëllim, por për arsye se është OJF, nuk është objekt i drejtpërdrejtë i auditit financiar¹¹⁵.



¹¹¹Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 95

¹¹²Evidenca nr.8: Raporti vjetor institucional për vitin akademik 2017 - 2018

¹¹³Evidenca nr.61: Buxheti vjetor i fondacionit

¹¹⁴Evidenca nr.62: Rregullore e Bordit të Administrimit

¹¹⁵Evidenca nr.63: Të dhënat mbi financat dhe mjediset

(Handwritten signatures and initials in blue ink)

Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit

Institucioni disponon një sistem të informimit

Sistemi i informimit dhe menaxhimit të informacionit realizohet përmes dy njësive administrative, zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median dhe zyra e Teknologjisë së Informacionit. Detyrat e tyre parashikohen në rregulloren për organizimin administrativ¹¹⁶. Këto zyra koordinohen me njëra-tjetrën si për publikimin e informacioneve të ndryshme, ashtu edhe për ndërtimin e infrastrukturës teknike dhe teknologjike: faqet e internetit, profilet në rrjetet sociale, etj.

Në mbështetje të të gjithë këtij procesi, KU "Bedër" ka mundur për studentët dhe personelin edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (BIS - Bedër Information System)¹¹⁷. BIS siguron transparencë dhe objektivitet në lidhje me mënyrën e organizimit të procesit mësimor, që lidhet me lëndët, regjistrimin e studentëve dhe vlerësimin e tyre. Ky sistem i lejon studentëve dhe personelit, që të sigurojë informacion rreth procesit mësimor akademik dhe administrativ. Studentët dhe personeli kanë mundësi, që përmes fjalëkalimeve dhe adresave individuale, të ofruara nga institucioni, të përditësohen me çdo informacion.

Institucioni publikon në faqen e tij zyrtare www.beder.edu.al të dhënat e nevojshme në lidhje me programet e ofruara, ofertën akademike, organizimin dhe funksionimin e institucionit, si dhe statutin dhe rregulloret e funksionimit të tij. Zyra e Teknologjisë së Informacionit krijon, trajton, mirëmban dhe siguron vazhdimësinë e procesimit të të dhënave të institucionit përmes sistemit të automatizuar dhe ndihmon në mësimdhënie, kërkime dhe aktivitete administrative.

Gjithashtu, zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median organizon përgatitjen dhe prodhimin e të gjitha materialeve prezantuese, publikimin e informacionit në web dhe në sistemin e teknologjisë së informacionit dhe përditësimin e tij.

Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit

Infrastruktura teknike dhe teknologjike e institucionit mundëson një proces efektiv mësimdhënës dhe mësimnxënës. Çdo anëtar i personelit është i pajisur me një zyrë, që garanton kushtet e nevojshme të punës, ku ka edhe kompjuterin përkatës, lidhje interneti, adresë të personalizuar institucionale emaili, etj.

Kjo teknologji është e pranishme edhe në të gjitha sallat, ku zhvillohen leksionet, ku

¹¹⁶Evidenca nr.12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ

¹¹⁷Evidenca nr.64: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)

përveç kompjuterit dhe internetit, në to janë montuar edhe tabelat elektronike (Smart Board)¹¹⁸.

Gjithashtu, institucioni, në varësi të nevojave të departamenteve ka vënë në dispozicion edhe laboratorin e kompjuterëve, news room e pajisur me teknologjinë përkatëse, etj. Për aktivitete më të gjera, KU "Bedër" ka në funksion sallën e konferencave të pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, sallën e senatit, etj., të cilat mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve, përfshirë këtu organizimin e videokonferencave, mbrojtje të tezave, etj.

Gjatë periudhës së pandemisë, stafi akademik ka përdorur në distancë platforma të ndryshme online, si *Google classroom*, *Google Meet*, *Zoom*, *Skype*, etj. Stafi akademik dhe studentët kanë mundësinë gjithashtu të gjejnë informacione të ndryshme në lidhje me procesin akademik në faqen website të institucionit.

Institucioni menaxhon pasuritë e paluajtshme

KU "Bedër" vazhdon aktivitetin e tij në mjedise të kontraktuara me qira¹¹⁹. Nga ana tjetër, KU "Bedër" ka në politikën e tij ndërtimin e një kampusi të ri universitar, i cili do të garantojë kushte bashkëkohore për aktivitetin akademik. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zotëron pronësinë e një trualli për ndërtimin e kampusit, dhënë nga qeveria shqiptare me vendim të Këshillit të Ministrave.

Institucioni ka gjithashtu një evidencë të pasurive të paluajtshme të tij¹²⁰, si dhe një master-plan për sigurinë, rehabilitimin, zgjerimin dhe/ose ristrukturimin e pasurive të paluajtshme të tij.¹²¹

Institucioni menaxhon asetet e tij sipas një plani të përcaktuar, si dhe mbikëqyr projektet e tij të ndërtimit dhe rindërtimit.

Institucioni siguron ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore

KU "Bedër" organizon çdo vit konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në përfundim të të cilave publikohen edhe librat e referimeve, të identifikuar me kodin ISBN, lëshuar nga Biblioteka Kombëtare. Në kuadër të ruajtjes së trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore, institucioni dorëzon pranë Bibliotekës Kombëtare nga pesë kopje për çdo botim të realizuar, ndërsa në bibliotekën e institucionit dorëzohen dy kopje për çdo punim teze masteri, si dhe nga një kopje në zyrën e Sekretarisë Mësimore.

Institucioni zhvillon disa konferenca periodike kombëtare dhe ndërkombëtare.

¹¹⁸Evidenca nr.65: Lista e aseteve teknologjike

¹¹⁹Evidenca nr.66: Kontrata e qirasë

¹²⁰Evidenca nr.67: Certifikata e pronësisë

¹²¹Evidenca nr.68: Planimetria e godinës



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page, including several illegible names and a date '2021'.

fakulteteve dhe departamenteve të ndryshme. Këto kanë logon, inicialet dhe linkun e tyre, të cilat publikohen në faqen zyrtare të universitetit, bashkë me të gjitha të dhënat dhe detajet në lidhje me organizimin, bordin shkencor, datat e rëndësishme e të tjerë, në përfundim të të cilave publikohet edhe libri i konferencës me ISBN (Proceedings) në webfaqen e universitetit¹²². Krahas këtyre konferencave, simpoziumeve zhvillohen edhe konferencat studentore, të cilat nxisin dhe inkurajojnë studentët për kërkim shkencor. Punimet më të mira të projekteve dhe tezave të Masterit të studentëve botohen edhe në revistat shkencore të fakulteteve të KU "Bedër", si dhe në revistën shkencore "Zani i Naltë", themeluar më 1923¹²³, revista në të cilat botohen dhe disa nga punimet më të spikatura të konferencave të organizuara nga institucioni.

Bazuar në misionin e KU "Bedër", i cili vlerëson mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënie në jetë të ideve dhe projekteve, të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, institucioni përmes udhëzimit "Mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor"¹²⁴, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, vlerëson arritjet akademike vjetore mbi indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse¹²⁵. Nga ana tjetër, rregullorja e arkivës¹²⁶ përcakton rregullat bazë për organizimin e funksionimin e shërbimit arkivor në KU "Bedër" për të gjitha dokumentet e krijuara nga organet drejtuese, njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë administrative ndër vite.

Institucioni ndjek në vijim një politikë të mirëmbajtjes dhe të zhvillimit të pasurive të tij akademike, kulturore dhe shkencore.

KU "Bedër" zotëron dy revista shkencore të pajisura me ISSN, të cilat publikohen në versionin e printuar dhe elektronik në webfaqen e institucionit¹²⁷:

- Beder Journal of Humanities (themeluar në vitin 2013)
- Beder Jurnal of Education Science (themeluar në vitin 2013).



¹²²Evidenca nr.69: Linqet e Websiteve të botimeve dhe konferencave, <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/botime-1-5/8/165>, <http://icid.beder.edu.al/>, <http://conf.beder.edu.al/iscon>, <http://ichl.beder.edu.al/>, <http://icess.beder.edu.al/>, <http://iccms.beder.edu.al/>, <http://icell.beder.edu.al/>

¹²³Evidenca nr.70: Shembull publikimi punimi <https://zanimalte.al/2019/11/analize-e-vepres-se-h-ali-krajes-a-duhet-feja-a-e-pengon-bashkimin-kombetar/>

¹²⁴Evidenca nr.28: Udhëzim mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor

¹²⁵Evidenca nr. 48: Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik

¹²⁶Evidenca nr. 71: Rregullorja e Arkivës

¹²⁷Evidenca nr.72: Linku për aksesimin e Websiteve të revistave shkencore, <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/revista-shkencore-8-13/8/164>






Institucioni ndjek një politikë të menaxhimit të aseteve të tij

Për një menaxhim sa më efektiv të aseteve infrastrukturore të institucionit, zyra e shërbimeve administrative është përgjegjëse për përdorimin dhe zhvillimin në mënyrën e duhur të hapësirave dhe kapaciteteve fizike të disponueshme.

E cituar edhe më sipër, KU "Bedër" ka një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për zhvillimin e aktivitetit të tij. Mjediset janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme, si: smart board, kompjuter, video-projektorë, mundësi kondicionimi, ndriçim natyral të mjaftueshëm, ndërsa ambientet e tjera, si: salla e konferencave, biblioteka etj., ndihmojnë në zhvillimin maksimal të mësimdhënies.

Gjithashtu, KU "Bedër" vë në dispozicion mjedise për veprimtaritë e personelit akademik, në përpjesëtim me numrin e tij¹²⁸.

Institucioni ngre një strukturë logjistike administrative për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët

KU "Bedër" vlerëson shërbimet logjistike duke realizuar çdo vit një anketë¹²⁹, e cila i drejtohet personelit akademik, administrativ dhe studentëve, në lidhje me cilësinë e shërbimeve, që ofron KU "Bedër" dhe çfarë duhet të përmirësojë.

Institucioni që nga krijimi i tij ka ngritur zyrën e Financës dhe Çështjeve Administrative, e cila është përgjegjëse për përdorimin dhe zhvillimin në mënyrën e duhur të hapësirave dhe mundësive fizike, që disponon KU "Bedër" dhe sigurinë e saj¹³⁰.

Në kuadër të bashkëpunimit me palë të treta, si edhe në funksion të nevojave të tregut, KU "Bedër" ka ofruar ambientet e tij për zhvillimin e provimeve të gjuhës angleze, si TOEFL, APTIS, etj.

Menaxhimi i Veprimtarisë së Institucionit

Institucioni siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore

KU "Bedër" kryen aktivitetin e tij në dy godina të kontraktuara me qira: godina A me sipërfaqe 1604 m² dhe godina B me sipërfaqe 1360 m² përfshi dhe ambientet sportive me sipërfaqe 630 m², gjithsej 3594 m², me adresë Rr. Jordan Misja, Tiranë. Infrastruktura e përdorur plotëson kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", si dhe ligjin 80/2015

¹²⁸Evidenca nr.73: Raporti i kapaciteteve pritëse

¹²⁹Evidenca nr.74: Anketa e stafit akademik dhe stafit administrativ

¹³⁰Evidenca nr.12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Godinat janë të sapo rikonstruara dhe kompani të treta janë kontraktuar për mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre.

Ambientet kanë një infrastrukturë moderne dhe përbëhen nga 17 auditore, 1 sallë konferencash, 2 laboratorë kompjuterash, sallë gjyqesh dhe news room, të cilat përdoren për aktivitete mësimdhënëse. Përveç ambienteve që ofrohen brenda 2 godinave kryesore, vlerë e shtuar janë edhe ambientet e jashtme çlodhëse, sportive dhe çlodhëse, që pasurojnë në shumë dimensione jetën studentore, brenda hapësirës së universitetit.

Godinat janë të pajisura me sistem kaldaje, dalje emergjence, ambiente të shërbimit/teknike që u shërbejnë funksioneve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe mundësojnë burime alternative energjie dhe uji, pasi janë të pajisur me elektropompë e depo uji, si dhe gjenerator.

Kampusi është larg zonave industriale, apo me ndotje përtej normave të lejuara, në ambiente të ndërtuara me materiale cilësore që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe nuk shfaqin rrezikshmëri për studentët apo stafin akademik e administrativ.

Ambientet e caktuara për procesin arsimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit akademik.

Godinat kanë një infrastrukturë moderne dhe janë të pajisura me sistem ngrohjeje. Klasat janë të pajisura me video-projektorë dhe me tabela inteligjente (smart board), të cilat bëjnë të mundur zhvillimin me cilësi të procesit arsimor.

Ato janë të pajisura me karrige ortopedike dhe tavolina individuale, që sigurojnë akomodimin e rehatshëm dhe të sigurt të studentëve dhe pedagogëve, duke respektuar të gjitha protokollet e ruajtjes së higjienës dhe sigurisë. Përveç auditorëve, institucioni ka edhe ambiente çlodhëse për studentët, bibliotekë, mjedise për Këshillin Studentor, klubet studentore, etj.

Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike

Me qëllim ruajtjen e veprimtarisë akademike dhe administrative, KU "Bedër" ka një rregullore të posaçme për arkivimin dhe menaxhimin e dokumentacionit¹³¹.

Institucioni ka ndarë mjedise të posaçme për arkivimin e dokumentacionit në letër. Çdo punonjës është i pajisur me kompjuter personal, por në fund të çdo viti të dhënat kalohen në një memorie digjitale të jashtme (hard disc). Çdo zyrë në KU "Bedër" nxjerr statistika,

¹³¹Evidenca nr.71: Rregullorja e Arkivës

për të cilat është e ngarkuar. Këto statistika dorëzohen në rektorat. Sekretaria mësimore në KU "Bedër" është përgjegjëse për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave për regjistrimin e studentëve, pajisjen me numër matrikullimit, etj., në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, si dhe rregulloren e zyrës së sekretarisë mësimore¹³².

Në lidhje me kurrikulat mësimore, brenda institucionit ekziston zyra e zhvillimit të kurrikulave, e cila koordinon zhvillimin e procesit kurrikular për të gjitha programet e reja dhe ekzistuese. Gjithashtu, kurrikulat e çdo programi bëhen publike edhe përmes faqeve në internet të çdo departamenti.

Institucioni disponon një regjistër të studentëve (në formë të shkruar dhe elektronike, që mbahet në ruajtje të përhershme), me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna për diplomën ose diplomat e marra, bashkë me suplementin e diplomës, numrin e matrikullimit etj., të gjitha këto në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Sekretaria mësimore është përgjegjëse për plotësimin dhe ruajtjen e regjistrave në fjalë.

Përfundimet dhe Vlerësimi

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm vlerëson se për fushën e vlerësimit "Burimet" standardet janë përmbushur plotësisht.

Institucioni, nëpërmjet rregulloreve përkatëse, ka përcaktuar qartë funksionet dhe detyrat e organeve akademike dhe administrative, si dhe përshkrimet e punës për çdo pozicion. Kjo gjë siguron menaxhimin efektiv të aktivitetit të tij.

Institucioni ndjek politika efikase për punësimin, vlerësimin dhe promovimin e personelit, praktikë kjo që ka ndihmuar në sigurimin e punësimit të një personeli të kualifikuar akademik e administrativ. Institucioni ndjek dhe zhvillon në mënyrë të vazhdueshme politikat për mbështetjen e personelit me programe të trajnimit dhe të formimit të vazhduar.

Institucioni ka një sistem të mirorganizuar dhe efektiv të informimit, i cili u mundëson studentëve dhe personelit të sigurojnë informacion të plotë rreth procesit akademik dhe administrativ. Ky sistem mbështetet në një infrastrukturë bashkëkohore, që përfshin edhe Sistemin e Informimit (BIS – Bedër Information System).

Institucioni ka siguruar mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për organizimin e veprimtarisë akademiko-shkencore dhe mbetet i angazhuar për ndjekjen dhe përmirësimin

¹³²Evidenca nr.75: Rregullotja e zyrës së sekretarisë mësimore



(Handwritten signatures and dates in blue ink)

e tyre.

Institucioni siguron ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet njësive përkatëse dhe ka në dispozicion dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.

Buxheti dhe shpërndarja e tij bëhen përmes procedurave transparente dhe të mirëpërcaktuara. Ky buxhet është i detajuar dhe i deleguar deri në njësinë bazë.

Duke qenë se institucioni është riorganizuar, duke u zgjeruar me disa programe të reja, kryesisht në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, po bëhet i mundur rekrutimi edhe i disa anëtarëve të rinj, të profilizuar në fusha konkrete, për të cilët departamentet kanë nevojë.



33

3. FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA

Programet e Studimeve të ofruara

Institucioni ofron programe në përputhje me misionin dhe kushtet e infrastrukturës së tij

KU "Bedër", si një institucion me një mision të qartë në përgatitjen e profesionistëve nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë, ofron programe studimi, të cilat reflektojnë interesat e prioritetet kombëtare të vendit.^{133 134} Me qëllim realizimin e këtij misioni, Kolegji ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, drejtësisë, teknologjisë dhe biznesit, duke sjellë një profil të qartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.^{135 136} Programet e ofruara janë të ndara në dy fakultete, gjashtë departamente^{137 138} dhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion.¹³⁹ Këto programe studimi, nën koordinimin e zyrës së Zhvillimit të Kurrikulës, janë organizuar në mënyrë të tillë që të harmonizojnë të gjitha komponentët e përcaktuar në aktet ligjore dhe nën ligjore përkatëse.¹⁴⁰ Në përputhje me to janë hartuar dhe silabuset për çdo kurrikul.¹⁴¹

KU "Bedër" zhvillon takime me drejtuesit e shkollave të mesme në të gjithë vendin dhe veçanërisht me drejtuesit e institucioneve të arsimit të mesëm ku kanë përfunduar shkollën pretenduesit për studentë, me qëllim njohjen me ofertën akademike. Gjatë panairëve të këshillimit të karrierës, pretenduesit e interesuar njihen me misionin dhe objektivat e programeve si dhe me politikën e pranimit të studentëve në përputhje me programet e studimeve që ofrohen.¹⁴²

KU "Bedër" siguron mundësinë që programet e studimit të njihen nga publiku nëpërmjet faqes së internetit, por edhe nëpërmjet materialeve të ndryshme mbështetëse, si: broshura,

¹³³Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 4

¹³⁴ Evidenca nr.17: Plani strategjik institucional 2018-2023

¹³⁵Evidenca nr.14: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, neni 3

¹³⁶ Evidenca nr.13: Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, neni 3

¹³⁷Evidenca nr. 14: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, nenet 4, 5 dhe 15

¹³⁸ Evidenca nr.13: Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, nenet 4, 5 dhe 15

¹³⁹Evidenca nr.76: Rregullore e Qendrës për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion, neni 2

¹⁴⁰Evidenca nr.77: Linku i Udhëzimit Nr.15, Datë 04.04.2008 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.41 Datë 24.01.2018

¹⁴¹ Evidenca nr.78: Linku i një silabusi të publikuar në faqen zyrtare

¹⁴²Evidenca nr.79: Vendim Senati mbi kriteret e pranimit



(Handwritten signatures and initials)

guida, si dhe nga pjesëmarrja në panairë, nga prezantimi nëpër shkolla, ditët e hapura etj.¹⁴³ Çdo department ka faqen e tij të webit ku mund të gjenden programet e studimeve si dhe kurrikulat përkatëse.¹⁴⁴

Mënyra dhe vlerësimi i aftësive të studentëve është parashikuar në rregulloren themelore,¹⁴⁵ rregulloret për studimet e ciklit të parë dhe të dytë dhe provimeve.^{146 147}

Rregulloret sanksionojnë që ankimimet e studentëve lidhur me vlerësimin shqyrtohen dhe klasifikohen nga një komision i posaçëm i ngritur nga Departamenti.^{148 149}

KU "Bedër", për të realizuar misionin e tij, ka një infrastrukturë teknike dhe teknologjike e cila mundëson një proces efektiv mësimdhënës dhe mësimnxënës.¹⁵⁰ Kolegji kryen aktivitetin e tij në dy godina të kontraktuara me qira: godina A me sipërfaqe 1604 m², godina B me sipërfaqe 1360 m² dhe ambientet sportive me sipërfaqe 630 m², në total 3594 m², me adresë Rr. Jordan Misja, Tiranë. Godinat kanë një infrastrukturë moderne, të përshtatura edhe për studentët më aftësi ndryshe dhe janë të pajisura me kondicionerë. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjithashtu institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve sallën e bibliotekës, të pajisur me tavolina, karrige, kompjutera, Wi-Fi, dritë natyrale dhe bibliotekën online;¹⁵¹ laboratorët e kompjuterave, news room e pajisur me teknologjinë përkatëse. Godinat janë të pajisura me sistem kaldaje, dalje emergjence, ambientet e shërbimit/teknike që i shërbejnë funksioneve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe mundësohen burime alternative energjie dhe uji, pasi ndërtesa është e pajisur me elektropompë e depo uji, si dhe gjenerator. Nga ana tjetër, KU "Bedër" ka nisur ndërtimin e kampusit të ri universitar, i cili në përfundim do të garantojë kushte bashkëkohore për aktivitetin akademik.^{152 153}

Gjatë periudhës së pandemisë, Senati akademik miratoi një plan masash mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor si dhe udhëzimin mbi mësimdhënien në distancë.¹⁵⁴ Gjithashtu, KU

¹⁴³Evidenca nr. 80: Broshurë për ofrimin e ofertës akademike

¹⁴⁴Evidenca nr. 81: Webfaqja e Departamentit të Shkencave të Komunikimit

¹⁴⁵Evidenca nr. 10: Rregullorja Themelore, neni 92

¹⁴⁶Evidenca nr. 82: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 16

¹⁴⁷ Evidenca nr. 83: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, neni 42

¹⁴⁸Evidenca nr. 82: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 24

¹⁴⁹ Evidenca nr. 83: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, neni 36


¹⁵⁰Evidenca nr. 63: Të dhënat mbi financat dhe mjediset

¹⁵¹Evidenca nr. 84: Marrëveshja për akses në JSTOR

¹⁵²Evidenca nr. 67: Certifikata e pronësisë

¹⁵³ Evidenca nr. 68: Planimetria e godinës

¹⁵⁴Evidenca nr. 85: Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë

"Bedër" mori masa për respektimin e protokolleve higjeno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë dhe Covid-19.¹⁵⁵

Formimi i vazhdueshëm është pjesë integrale e programeve të studimeve

Duke u bazuar në Deklaratën e Bolonjës, nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë, KU "Bedër" nxit frymën e formimit të vazhdueshëm, i cili është një çështje, së cilës i jepet prioritet edhe në planin strategjik, ku parashikohen përparësitë për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij.¹⁵⁶ Në këtë kuadër, KU "Bedër" ofron një sërë metodash dhe modulesh që synojnë formimin e vazhdueshëm të personelit,¹⁵⁷ zhvillimin e mëtejshëm individual dhe mosshkëputjen nga marrëdhënia e punës me institucionin.¹⁵⁸

Për këtë arsye, pranë KU "Bedër" është ngritur Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion në kuadër të së cilës organizohen një sërë specializimesh. Qendra kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimore në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe inovacionit. Në kuadrin e projekteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, qendra kërkimore bashkëpunon me njësi të tjera kërkimore shkencore brenda dhe jashtë vendit.¹⁵⁹ Formimi i vazhdueshëm është një çështje, së cilës i jepet prioritet edhe në Planin strategjik, ku parashikohen prioritetet për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të qendrës në fjalë.¹⁶⁰

Krahas ofrimit të programeve të studimeve të formimit të vazhduar (specializime afatshkurtra, plotësim, thellim dhe freskim të njohurive) si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës për stafin akademik, KU "Bedër" i kushton një rëndësi të veçantë formimit të vazhduar të studentëve.¹⁶¹ Për të arritur këtë qëllim, pranë KU "Bedër" është ngritur zyra e planifikimit të karrierës, në kuadër të së cilës janë organizuar një sërë seminaresh dhe praktika (internshipe). Qëllimi i organizimit të seminareve është që të përgatisë studentët me aftësitë e nevojshme për t'iu përshtatur tregut të punës. Ndërsa, praktikat (intershipet) në disa programe janë pjesë e kurrikulës, ndërsa në disa programe të tjera ato ofrohen me qëllim gërshetimin e njohurive teorike me ato praktike.¹⁶² Në përfundim parashikohet

¹⁵⁵ Evidenca nr. 86: Rregullorja mbi marrjen e masave higjeno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë dhe Covid-19

¹⁵⁶ Evidenca nr. 17: Plani strategjik institucional 2018-2023, III B

¹⁵⁷ Evidenca nr. 52: Lista e trajnimeve të stafit, viti akademik 2019-2020

¹⁵⁸ Evidenca nr. 87: Shembull, Vendim Senati për përparimin akademik, Dr. Gentjan Skara

¹⁵⁹ Evidenca nr. 76: Rregullore e Qendrës për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion, neni 2

¹⁶⁰ Evidenca nr. 17: Plani strategjik institucional 2018-2023, B 2

¹⁶¹ Evidenca nr. 17: Plani strategjik institucional 2018-2023, B 1

¹⁶² Evidenca nr. 88: Shembull i një kurrikule program studimi



[Handwritten signatures]

[Handwritten signature]

[Handwritten signatures]

vlerësimi i saj.¹⁶³ Veprimtaria dhe organizimi i kësaj zyre kryhet në bazë të dispozitave të parashikuara në rregulloren mbi organizimin administrativ.¹⁶⁴

Një element i rëndësishëm për formimin e vazhdueshëm për studentët është edhe organizimi i shkollave verore nga disa departamente. Qëllimi i ofrimit të këtyre shkollave verore është thellimi më tej i njohurive për lëndë specifike.¹⁶⁵

Për semestrin akademik pranverë 2019-2020 dhe vjeshtë 2020-2021, institucioni hartoi një material udhëzues mbi metodat dhe platformat e mësimdhënies në distancë. Institucioni realizoi trajnime online për stafin akademik dhe studentët për përdorimin e platformës G-Suite për realizimin e procesit mësimor në kushtet e situatës së pandemisë Covid-19. Këto udhëzues dhe aktivitete janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit dhe në platforma të tjera.^{166, 167, 168, 169, 170}

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit

Në përmbushje të misionit të tij, KU "Bedër" ofron programe studimi në përputhje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit. Plani strategjik i institucionit është përgatitur, duke marrë parasysh elemente të rëndësishme, një ndër të cilat është mësimdhënia, e parashikuar kjo në mënyrë të detajuar në pjesën III pika A të këtij plani. Në përmbushje të këtij kriteri, KU "Bedër" ofron informacion të detajuar, të vazhdueshëm dhe të përditësuar për të gjithë kandidatët e interesuar për të vazhduar studimet në këtë institucion, si dhe për studentët që vijojnë studimet.^{171,172}

Oferta akademike e programeve të studimeve integron në mënyrë koherente informacionin për diplomat që lëshohen në përfundim të studimeve.^{173 174 175} Guida e studentëve, me të cilën ata pajisen në momentin e regjistrimit, ofron ndihmë teorike dhe praktike për veprimet, me të cilat studentët përballen gjatë jetës universitare.

Informacioni, në lidhje me programin, me emërtimin e diplomës dhe suplementin e saj,

¹⁶³Evidenca nr. 89: Vlerësimi i praktikave mësimore

¹⁶⁴Evidenca nr. 12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ, neni 41

¹⁶⁵Evidenca nr. 90: Semestri i verës

¹⁶⁶Evidenca nr. 85: Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë

¹⁶⁷Evidenca nr.17: Plani strategjik institucional 2018-2023

¹⁶⁸Evidenca nr. 91: Video Trajnimi për platformën: www.one.beder.edu.al,

https://drive.google.com/file/d/1ObEG3t7MHd_rgl1541YR-kW_T0BUY76Q/view?usp=drivesdk

¹⁶⁹Evidenca nr. 92: Video Trajnimi: Menaxhimi i një klase virtuale në Google Classroom, <https://youtu.be/-fLD-A6F28w>

¹⁷⁰Evidenca nr. 93: Video Trajnimi: Creating Meet Event on Google Classroom, <https://youtu.be/Y17fgKFPcCk>


¹⁷¹Evidenca nr. 80: Broshurë për ofrimin e ofertës akademike

¹⁷² Evidenca nr. 51: Guida e studentit

¹⁷³Evidenca nr.10: Rregullorja Themelore, neni 89

¹⁷⁴Evidenca nr.82: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 3;

¹⁷⁵Evidenca nr.83: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, neni 5.



dhe mundësitë e punësimit i prezantohet studentit përmes guidës së studentit, kontratës që nënshkruan,¹⁷⁶ faqes së internetit të departamentit përkatës dhe përmes takimeve të zhvilluara në kuadër të ditëve të orientimit.

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë

Programet e studimit të ofruara nga KU "Bedër" janë në përputhje të plotë me objektivin për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Politikat e KU "Bedër" janë hartuar në kuadër të politikave kombëtare, të parashikuara në planin strategjik për arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. KU "Bedër" synon promovimin e kulturës dhe të traditës shqiptare, ndërkohë që nxit larminë kulturore. Respektimi i vlerave akademike dhe kulturore kombëtare përfshihet natyrshëm në programet e studimit duke i ofruar studentëve një formim të plotë dhe të gjithanshëm, për t'i bërë ata të gatshëm për tu përballur me kushtet e një tregu të hapur.¹⁷⁷

Kolegji Universitar "Bedër" synon krijimin dhe konsolidimin e një profili ndërkombëtar, duke mundësuar pranimin e studentëve nga trevat shqipfolëse në rajon dhe në diasporë, si edhe nga disa vende të Europës dhe më gjerë. Përbërja e personelit akademik pasqyron profilin ndërkombëtar të KU "Bedër", i cili përforcohet me marrëveshjet e bashkëpunimit të vendosura me universitetet ndërkombëtare.¹⁷⁸

Në këtë kontekst, KU "Bedër" ka nxitur pranimin e studentëve nga disa vende të ndryshme si: Kosova, Mali i Zi, Serbia, Turqia dhe Maqedonia e Veriut. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë globalizimin dhe aspiratat e Shqipërisë në procesin e integritimit Evropian, KU "Bedër" ofron disa programe në gjuhë të huaja me qëllim integrimin në tregun e punës ose mundësinë për të vazhduar studime të mëtejshme.^{179 180 181}

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit në dy aspekte. Lidhur me aspektin e kapaciteteve, siç shpjegohet më sipër, KU "Bedër" kryen aktivitetin e tij në dy godina të kontraktuara me qira, me sipërfaqe në total 3594 m²¹⁸². Ambientet kanë një infrastrukturë moderne dhe përbëhen nga 17 klasa, 1 sallë konferencash, 2

¹⁷⁶Evidenca nr.94: Shembull Kontratë Studenti

¹⁷⁷Evidenca nr.27: Shembull i Raportit të aktiviteteve të një njësie bazë

¹⁷⁸Evidenca nr.37: Lista e institucioneve partnere

¹⁷⁹Evidenca nr.10: Rregullorja Themelore, neni 53

¹⁸⁰Evidenca nr.82: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 3

¹⁸¹Evidenca nr.83: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, neni 13

¹⁸²Evidenca nr.63: Të dhënat mbi financat dhe mjediset



(Handwritten signatures in blue ink)

laboratorë kompjuteri, sallë gjyqesh, news room të cilat përdoren për aktivitete mësimdhënëse. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjithashtu, përveç klasave të mësimt, ka dhe shumë ambiente çlodhëse për studentët, si mensë, bibliotekë, mjedise për Këshillin Studentor dhe klubet studentore etj.

Ndërsa lidhur me kapacitetin e burimeve njerëzore, KU "Bedër" ka si politikë të tërheqë staf të kualifikuar, kryesisht me grada shkencore e tituj shkencorë dhe standard të përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit.¹⁸³ Për të plotësuar nevojat për staf akademik me tituj shkencorë e grada shkencore, janë punësuar profesionistëve vendas dhe të huaj me përvojë në fushën akademike. Gjatë vitit akademik 2019-2020 në KU "Bedër" janë angazhuar 93 pedagogë (efektivë dhe joefektivë) për 634 studentë.

Në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, raporti studentë-pedagogë është 1 pedagog për 6.5 studentë, ndërsa në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit ky raport është 1 pedagog për 7.3 studentë. Raporti në fjalë i KU "Bedër" për vitin akademik 2019-2020, është 1 pedagog për 6.8 studentë (634 studentë – 93 pedagogë). Ky raport mundëson vit pas viti punën intensive me studentët për të mbështetur dhe monitoruar nga afër rritjen e tyre akademike dhe profesionale.¹⁸⁴

Programet e studimeve organizohen në mënyrë të tillë që t'i sigurohet personelit akademik, një harmonizim efektiv ndërmjet ngarkesës në mësimdhënie, punës kërkimore-shkencore dhe angazhimeve administrative.¹⁸⁵ ¹⁸⁶ Ngarkesa mësimore e pedagogëve caktohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kriteret e përlogaritjes së ngarkesës mësimore të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, të angazhuar në mësimdhënie në programet e ciklit të parë e të dytë, parashikohen në udhëzimin për ngarkesën mësimore të institucionit. Ky udhëzim parashikon edhe mënyrën e pagesës së orëve shtesë dhe kufijtë e lejuar të ngarkesës mbi normë të pedagogëve.¹⁸⁷

Programet e studimeve janë lehtësisht të kuptueshme dhe objektivat e tyre janë të përcaktuara qartë

Përmbajtja e programeve të studimeve, të kurrikulës, të programeve mësimore (silabuseve), janë në dispozicion të studentëve dhe sigurohen lehtë prej tyre nëpërmjet

¹⁸³Evidenca nr.17: Plani strategjik institucional 2018-2023

¹⁸⁴Evidenca nr.8: Raporti vjetor institucional për vitin akademik 2017 - 2018


¹⁸⁵Evidenca nr.59: Shembull i ngarkesës mësimore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit

¹⁸⁶Evidenca nr.58: Udhëzimi mbi ngarkesën mësimore

¹⁸⁷Evidenca nr.95: Shembull: Formular për pagimin e orëve të një pedagogu







aksesimit në faqen e web-it të departamenteve respektive. Në orën e parë të mësimit, pedagogu i lëndës diskuton me studentët silabusin e lëndës dhe i informon me detajet e zhvillimit dhe të vlerësimit të saj.

Objektivat e programeve të studimeve janë të përcaktuara në dosjet e dorëzuara në MASR në momentin e licensimit dhe janë të bëra publike nëpërmjet faqes së web-it të çdo departamenti.¹⁸⁸

Të gjitha këto detaje janë të përcaktuara në kurrikulën e programit të studimit të cilat u jepen studentëve në momentin e nënshkrimit të kontratës.

KU "Bedër" ka përcaktuar qartë kriteret e pranimit të studentëve. Me ndryshimet e reja ligjore, kriteret e pranimit të studentëve propozohen nga departamentet përkatëse, aprovohen nga dekanati i Fakultetit përkatës dhe miratohen nga Senati Akademik.¹⁸⁹ Këto kriteret janë të pasqyruara në faqen e Web-it të institucionit dhe u shpjegohen edhe studentëve gjatë panairit të studimit të organizuar nga MASR.¹⁹⁰

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme

Nisur nga harmonizimi i lëndëve që përbëjnë kurrikulat e programeve "Bachelor" dhe "Master", ato lejojnë një kalim progresiv nga njëri cikël te tjetri. Kompetencat e parashikuara si në përmbajtjen e programit pararendës edhe në atë të lëndëve që ai përmban, vijojnë më tej me një lidhje përmbajtësore dhe formuese për vazhdimin e ciklit pasardhës në fushën gjegjëse.

Bazuar në VKM 41/2018, programet e studimeve të ciklit të parë i pajisin studentët me njohuritë bazë, mbi metoda e parime të përgjithshme shkencore dhe formimin e shprehive të veçanta.¹⁹¹

E parashikuar në rregulloren mbi studimet dhe provimet e ciklit të parë (nenet 4, 9, 16, 33) si dhe në rregulloren e transferimeve, në KU "Bedër" studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve apo të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre.^{192 193}

Programet e studimeve të këtij cikli hartohen në përputhje me kërkesat e tregut të punës

¹⁸⁸Evidenca nr. 96: Shembull i një linku ku është publikuar kurrikula e programit, <https://emp.beder.edu.al/sh/content/default/programet-0-18/0/616>

¹⁸⁹Evidenca nr.79: Vendim Senati mbi kriteret e pranimit

¹⁹⁰Evidenca nr.97: Shembull i publikimit në Web të kriterëve të pranimit dhe dokumentacioni i nevojshëm <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/pranimet-ne-bachelor-8-1/6/151>

¹⁹¹Evidenca nr.77: Linku i Udhëzimit Nr.15, Datë 04.04.2008 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 14, Datë 24.01.2018

¹⁹²Evidenca nr.82: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

¹⁹³Evidenca nr.98: Rregullorja mbi transferimin e studimeve



(Handwritten signatures and initials in blue ink)

dhe legjisllacionin në fuqi, në mënyrë të tillë që studentët që përfundojnë ciklin e parë të kenë mundësi për punësim, të cilat janë të përshkruara dhe të përcaktuara në programin e çdo departamenti.

Programet e studimeve të ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që të lehtësohet ambientimi i studentit me mjedisin universitar

Institucioni ndjek politika mbështetëse për të siguruar mbarëvajtjen e studentëve dhe ambientimin e tyre me mjedisin universitar. Për këtë arsye është themeluar edhe dekanati i studentëve që ndër funksionet kyësore ka: "i) të angazhohet në zgjidhjen e problemeve të studentëve në lidhje me jetën universitare, në bashkëpunim me njësitë administrative dhe akademike; dhe ii) të kryejë veprimtari për të rritur cilësinë e jetesës në fusha të tilla si akomodimi, transporti dhe atë të aktiviteteve sociale në mjediset universitare."¹⁹⁴ Çdo departament ka caktuar një këshilltar karriere me qëllim që të ofrojnë konsulencën e tyre për studentët e KU "Bedër".^{195 196} Nën kujdesin e dekanit të studentëve, dy ditët e para të çdo viti akademik, i kushtohen orientimit të studentëve të rinj në lidhje me mundësitë që institucioni ofron.¹⁹⁷

Çdo departament emëron një këshilltar akademik për çdo vit studimi, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Këshilltari ndjek dhe udhëzon studentin mbi anën akademike, gjatë periudhës studimore. Këshilltari miraton online regjistrimin semestral për çdo student përkatës.¹⁹⁸

Institucioni ka të shprehur në statut dhe në rregullore parimet e lirisë akademike, e cila përveç të tjerash, përkthehet edhe në liri të metodave të ndryshme të mësimdhënies. Institucioni inkurajon metoda sa më të larmishme të mësimdhënies, me një qëllim të vetëm: arritjen e përsosmërisë në mësimdhënie, çka do të shërbejë që të kemi një cilësi dhe një nivel sa më të lartë të të nxëniet të studentët. Gjatë periudhës së pandemisë, Senati Akademik miratoi udhëzimin 'Mbi Mësimdhënien në Distancë' me qëllim që të orientonte lektorët *me kohë të pjesshme* dhe *me kohë të plotë* në punën e tyre virtuale me studentët në kushtet e shtëpisë dhe në kushtet e ndërprerjes së procesit mësimor në kuadër të masave të ndërmarra nga qeveria shqiptare për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19.¹⁹⁹

KU "Bedër" punëson me përparësi personelin akademik që angazhohet në veprimtari

¹⁹⁴Evidenca nr.12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ, Neni 40 (2) (a;d)

¹⁹⁵Evidenca nr.12: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ, Neni 41 (3)

¹⁹⁶Evidenca nr.99: Vendimi i përcaktimit të këshilltarëve të karrierës

¹⁹⁷Evidenca nr.49: Programi i ditëve të orientimit, viti akademik 2019-2020

¹⁹⁸Evidenca nr.82: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 6

¹⁹⁹Evidenca nr.85: Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë



kërkimore-shkencore. KU "Bedër" i kushton një rëndësi të veçantë përzgjedhjes së stafit akademik, duke synuar përputhjen e interesave të tyre me programet që ofrohen.

Duke plotësuar të gjitha standardet e parashikuara në legjislacionin shqiptar, në lidhje me numrin e stafit akademik për çdo departament, KU "Bedër" ka punësuar edhe personel me kohë të pjesshme, i cili angazhohet në disa fusha specifike. Institucioni mbulon nga personeli me kohë të plotë mbi 70% të programeve. Kjo përqindje ndryshon sipas programeve të studimit, varësisht specifikeve që kanë fushat përkatëse.

Programet e studimeve të ciklit të dytë mbështeten mbi kërkimin dhe për realizimin e tyre; institucioni bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike

Pedagogët që angazhohen në veprimtari kërkimore-shkencore përbëjnë pjesën më të madhe të stafit akademik. Personeli akademik gjatë viteve ka qenë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në zhvillimin e kërkimit-shkencor.²⁰⁰ I njëjti personel luan rol aktiv në hartimin dhe zbatimin e programeve të studimeve. Programet e studimeve "Master i shkencave" janë hartuar në mbështetje të politikave kërkimore të KU "Bedër".

KU "Bedër" u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Në këtë kontekst, gjatë semestrit të dytë, studentët nxiten dhe u ofrohet të ndjekin praktika profesionale si pjesë e detyrueshme e kurrikulës dhe praktikë profesionale vullnetare.²⁰¹ Për të lehtësuar gjetjen e vendeve të praktikave për studentët, KU "Bedër" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat në Shqipëri e më gjerë.²⁰²

Falë ngritjes së zyrës së të diplomuarëve (Alumni) dhe planifikimit të karrierës në varësi të dekanit të studentëve, është ndjekur edhe vijueshmëria e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve.

Duke plotësuar të gjitha standardet e parashikuara në legjislacionin shqiptar në lidhje me numrin e personelit akademik për çdo departament, KU "Bedër" ka punësuar edhe personel me kohë të pjesshme, i cili angazhohet në disa fusha të veçanta.

Nga ana tjetër, përqindja e programeve të mbuluara nga personeli me kohë të plotë është rritur në mënyrë të ndjeshme këto vite akademike.



²⁰⁰Evidenca nr.28: Udhëzim mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor

²⁰¹Evidenca nr.100: Listë e praktikave studentore

²⁰²Evidenca nr.37: Lista e institucioneve partnere

(Handwritten signatures in blue ink)

Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me Procesin e Bolonjës në cikle të njëpasnjëshme, sipas sistemit "Bachelor" dhe "Master".

Mënyra e organizimit të programeve mësimore lejon transparencë dhe lehtësi për t'i kuptuar ato, pasi strukturimi i tyre bëhet në varësi të kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programet janë të detajuara dhe të vlerësuara në kredite europiane, sipas "Sistemit european të transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS)". E gjithë përmbajtja e programeve është e arritshme përmes faqes së Web-it si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze. Diplomat, që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës.²⁰³

Gjuha e huaj është një ndër kriteret për pranim në disa nga programet "Bachelor" dhe "Master profesional". Ndërkohë, në programet "Master i shkencave" ajo është kriter hyrës, gjë që ndihmon dhe lehtëson mobilitetin e studentëve në vende të ndryshme. Gjithashtu, mësimi i gjuhëve të huaja është në përputhje me politikën e ndërkombëtarizimit të studimeve në KU "Bedër". Nga ana tjetër, institucioni ofron disa programe të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, mësimdhënia e të cilave zhvillohet në gjuhën angleze.

Institucioni favorizon mësimin e gjuhës shqipe nga studentët e huaj. Kreditet e fituara në një institucion të huaj të arsimit të lartë, pas vlerësimit nga njëسيا përkatëse, transferohen pranë IAL-së. KU "Bedër", mundëson transferim të krediteve të fituara brenda ose jashtë vendit, nëpërmjet njehsimit të pjesëve ose të programeve të plota të studimeve nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar shkollimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm në një institucion homolog.

Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, ku mund të përmendim marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me Universitetin Aurel Vlaicu Unversita of Arad, Rumani në kuadër të programit Erasmus+, Marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me College of Applied Sciences, "Lavoslav Rurilta" in Vukovar, Kroaci në kuadër të programit Erasmus+, etj.^{204,205}

Studentët e departamentit të Shkencave të Komunikimit kanë marrë pjesë në mënyrë

²⁰³Evidenca nr.10: Rregullorja Themelore, neni 89

²⁰⁴Evidenca nr.37: Lista e institucioneve partnere

²⁰⁵Evidenca nr.101: Shkresa për pranim në Erasmus+



43

[Handwritten signatures and initials in blue ink]

aktive në programe të ndryshme mobiliteti të mundësuar nga organizata dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim pjesëmarrjen e studenteve Sonja Hoxha, Bora Hasmadhi dhe Melsena Danglli në periudhën 4 korrik – 11 gusht 2019 në programin SUSI (Study of the U.S. Institutes) i cili është një program akademik 5 javor, për studentët ndërkombëtarë, nga mosha 18-25 vjeç. SUSI përfshin 4 javë mësim akademike, trajnime, diskutime, leksione dhe punë vullnetare. Ndërsa java e fundit konsiston në vizitat e vendeve të ndryshme në USA. Mesatarisht, në këto programe përzgjidhen 20 studentë nga shtete të ndryshme të botës. Studentët pjesëmarrës kanë mundësi të takohen dhe të shkëmbejnë eksperiencat me bashkëmoshatarët e tyre amerikanë, gjatë qëndrimit në kampus. Programi mbështetet nga Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH). Në fund të të gjitha aktiviteteve të planifikuara, studentët pajisen me certifikatë nga DASH. Në sezonin e verës 2020 dy studente të tjera të Departamenti të Shkencave të Komunikimit u përzgjedhën për të marrë pjesë në këtë program për sezonin Verë 2020, i cili më tej u anulua si pasojë e situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Departamenti i Shkencave Islame, për dy vite me radhë (2018 dhe 2019), ka organizuar vizita studimore pranë Universitetit të Vjenës dhe disa institucioneve të rëndësishme në Austri, me fokus studimet religjioze dhe dialogu ndërfaqor.

Ndërkohë, varësisht politikave institucionale dhe vizionit që u jepet studentëve, gjatë këtyre viteve ka pasur lëvizshmëri të tyre edhe të personelit në universitetet jashtë Shqipërisë.

Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike

Organizimi i programeve akademike u mundëson studentëve edhe praktikimin e aftësive teorike të marra në auditorë. Përveç lëndëve të praktikave profesionale që janë të detyrueshme brenda kurrikulës së programeve të ndryshme, departamentet, në bashkëpunim me dekanin e studentëve dhe klubet studentore, si edhe me këshilltarët për planifikimin e karrierës, mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të tjera ekstrakurrikulare, si: studenti dhe profesioni, MarCom Seminars, Akademia e Medias dhe Komunikimit, ditët e filmit, debatet e organizuara studentore, BrownBags Seminar, Rikthim në Bedër si Profesionist, arti i komunikimit në publik, montazhi, si dhe vizitat në qendrat për formim



44

(Handwritten signatures in blue ink)

me nevoja të veçanta. Aktivitetet e kësaj natyre janë të specifikuar më gjerësisht edhe në "Raportet e aktiviteteve" të njësive bazë pranë KU "Bedër".²⁰⁶

Për të mundësuar të studentit transferimet e mundshme edhe në universitetet jashtë Evropës, përbri ECTS-ve, KU Bedër ofron edhe sistemin amerikan të krediteve. Vlerësimet e lartpërmendura janë miratuar nga MASR, në momentin e licencimit të programeve akademike. Në çdo silabus të lëndës pasqyrohen kreditet në fjalë.

Programet e studimeve përfshijnë përgatitjen e paraqitjen e projekteve kërkimore të studentëve, të specifikuar shprehimisht në rregulloret e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, si edhe në rregulloret specifike të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Duke pasur parasysh lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, në programet e ciklit të dytë, studentët janë nxitur vazhdimisht të organizojnë si dhe të marrin pjesë në konferenca të ndryshme studentore.²⁰⁷

Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim

Programet e studimit të ofruara nga KU "Bedër" janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe synojnë t'i kontribuojnë nxitjes së zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Bazuar në nevojat reale të tregut të punës, institucioni ofron programe studimi në përputhje me strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi të cilat synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.

Nisur edhe nga përcaktimet që parashikon Karta e Bolonjës, kurrikulat e programeve të ofruara nga KU "Bedër" kanë në përbërjen e tyre edhe praktikën profesionale, e cila ndihmon studentët për gërshetimin e njohurive teorike dhe ato praktike.

Ndër synimet kryesore të programeve të studimit të ofruara nga KU "Bedër" janë:

- Të përgatisë profesionistë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës;
- T'u japë të diplomuarëve arsimim dhe trajnim të thelluar në fushën e programit ku ata studiojnë;
- Programet shtrojnë alternativa konkrete për zhvillimin e tyre në bazë të strategjisë kombëtare;
- Kualifikim i thelluar shkencor të studentëve me njohuri të zgjeruara në fushat e programeve ku ata studiojnë;
- Të rrisë profesionalizimin në drejtim të kërkimit shkencor në fushat ku ofrohen këto programe studimi;
- Të përgatisë profesionistë të aftë për të punuar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar

²⁰⁶Evidenca nr.27: Shembull i Raportit të aktiviteteve të një njësie bazë

²⁰⁷Evidenca nr.102: Linku i Konferencës Studentore në Shkenca Komunikimi








të punës;

- Të pasqyrojë diversitetin e individëve dhe atë kulturor në shoqëri;
- Të kuptojnë dhe demonstrojnë etikën profesionale; zhvillimin e të menduarit kritik dhe të pavarur;
- Të tregohen kompetentë në rolin që do të marrin në fushën ku do të angazhohen.

Përfundimet dhe Vlerësimi

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për fushën e vlerësimit "Kurrikula" konstaton se standardet **janë përmbushur plotësisht.**

Programet e studimit të ofruara janë në përputhje të plotë me misionin e institucionit, duke ofruar programe studimi në fushën e shkencave humane, drejtësisë, teknologjisë dhe biznesit, me një profil të qartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Kolegji Universitar "Bedër" nxit frymën e formimit të vazhdueshëm, duke e bërë atë pjesë integrale të programeve të studimeve.

KU "Bedër" ofron programe të studimeve në përputhje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit, përcaktuar në planin strategjik të institucionit, për të cilat ofron informacion të detajuar për të gjithë studentët dhe kandidatët e interesuar. Programet e studimeve janë lehtësisht të kuptueshme me objektiva të përcaktuara qartë dhe të arritshme.

Politikat e KU "Bedër" janë hartuar në kuadër të Kartës së Bolonjës dhe politikave kombëtare, të parashikuara në planin strategjik për arsimin e lartë të MASR.

Ngarkesa mësimore e pedagogëve caktohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe në udhëzimet e brendshme të institucionit, e cila bën të mundur një harmonizim efektiv midis ngarkesës së mësimdhënies dhe angazhimeve të tjera.

Institucioni vlerëson dhe ndjek politika mbështetëse për ecurinë e studentëve, të parashikuara këto në rregulloret përkatëse dhe për këtë qëllim ka ngritur struktura të posaçme.

Për t'u mundësuar studentëve praktikimin e aftësive teorike dhe përgatitjen për punësim u kushtohet rëndësi e veçantë praktikave profesionale, që zhvillohen brenda dhe jashtë vendit.



4. FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, **VLERËSIMI DHE KËRKIMI**

Organizimi i Programeve të Studimeve

Programet e studimeve të shpallura zbatohen në kushte të përshtatshme

Institucioni merr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor për çdo program. Në çdo fillim semestri miratohen ngarkesat mësimore, shpërndarja e lëndëve, mbledhja e dokumentacionit përkatës për çdo lëndë, hartimi dhe përditësimi i programeve mësimore (silabuseve), etj.²⁰⁸

Në varësi të nevojave të programeve akademike, KU "Bedër" ofron mjedise që ndihmojnë studentin për aftësimin praktik dhe formimin profesional. Të tilla janë auditorët e ndryshëm të pajisur me kompjutera dhe tabela elektronike, Newsroom, laborator i kompjuterave, salla e konferencave, laborator i gjuhëve të huaja, salla e gjyqit, etj.²⁰⁹.

Nën kujdesin e dekanit të studentëve, konkretisht zyrës së planifikimit të karrierës, KU "Bedër" mbikëqyr praktikën dhe stazhet që kryejnë studentët. Për programe të caktuara, si ato në fushën e edukimit, ekziston një formular dhe procedurë e caktuar për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e praktikës.

Në lidhje me përgatitjen e temave të diplomës, apo tezave të masterit, çdo student udhëzohet nga një udhëheqës shkencor.

Në mbështetje të mbarëvajtjes së procesit akademik, KU "Bedër" ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit bibliotekën e institucionit, e cila ofron një gamë të gjerë titujsh. Në bibliotekë gjenden 22.600 tituj shkencorë, 26.000 libra shkencorë, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore, si dhe studentët kanë mundësi akses në bibliotekën online JSTOR.

Institucionet e Arsimit të Lartë pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar

Studentët e regjistruar në ciklin e parë ose të dytë të studimeve në Kolegjin Universitar Bedër mund të diplomohen vetëm pas shlyerjes së detyrimeve të përcaktuara në rregulloret përkatëse^{210 211}, të cilat përfshijnë vijueshmërinë në një përqindje të caktuar, notën mesatare, si dhe provimin përfundimtar ose punimin e diplomës në varësi të programit. Të


²⁰⁸Evidenca nr.59: Shembull i ngarkesës mësimore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit

²⁰⁹Evidenca nr.103: Lista e aseteve të institucionit

²¹⁰Evidenca nr.82: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

²¹¹Evidenca nr.83: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë







gjitha këto kritere u bëhen të ditura studentëve në javën e orientimit, në faqen e universitetit si dhe me anë të guidës studentore²¹², me të cilën studentët pajisen çdo fillim viti akademik. KU "Bedër" disponon format provimi tip²¹³, i cili përmban elementët: emërtimin e fakultetit dhe të departamentit, emërtimin dhe kodin e lëndës, datën, orën, sallën, emrin e lektorit dhe numrin e studentit. Mbarëvajtja dhe organizimi sa më efikas i provimeve rregullohet me anë të udhëzimit të posaçëm për rregullat e provimeve^{214, 215} si dhe rregullores së disiplinës së studentëve²¹⁶, e cila parashikon masat disiplinore në këtë drejtim.

Rregullorja e studimit dhe e provimeve për secilin cikël të studimeve, parashikon edhe ankimimin e rezultateve dhe procedurat përkatëse. Studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin e një provimi në një afat kohor 5-ditor pas shpalljes së rezultateve me anë të një kërkesë në sekretarinë mësimore. Pas aplikimit për ankimim, ngrihet një komision i posaçëm nga këshilli i departamentit, në të cilin pedagogu i lëndës nuk mund të jetë anëtar²¹⁷.

Studentët të cilët përfundojnë me sukses studimet në programet e ofruara nga KU "Bedër" pajisen me diplomën përkatëse të regjistruar paraprakisht në regjistrin e diplomave dhe Certifikatave në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë²¹⁸.

Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë

Për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit janë ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)²¹⁹ si dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë²²⁰. Funksionimi dhe kompetencat e NJSBC-së janë të përcaktuara në statutin e Kolegjit Universitar Bedër²²¹ dhe në rregulloret përkatëse^{222, 223}.

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë, KU "Bedër" ka aplikuar²²⁴ dhe është pranuar në projektin "Bologna Hub Peer Support"²²⁵. Projekti ka filluar në shtator 2020 dhe

²¹²Evidenca nr.51: Guida e Studentit

²¹³Evidenca nr.104: Fletë Provimi Tip

²¹⁴Evidenca nr.82: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

²¹⁵Evidenca nr.83: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë

²¹⁶Evidenca nr.105: Rregullorja e disiplinës së studentëve

²¹⁷Evidenca nr.106: Formular Ankimimi

²¹⁸Evidenca nr.107: Shembull Format Diplome

²¹⁹Evidenca nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

²²⁰Evidenca nr.108: Vendimi për ngritjen e komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit

²²¹Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 28-29

²²²Evidenca nr.4: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

²²³Evidenca nr.21: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit

²²⁴Evidenca nr.109: Formulari i aplikimit në Bologna Hub Peer Support



(Handwritten signatures and initials in blue ink)

koordinohet nga German Academic Exchange Service (DAAD) në kuadër të Erasmus+. Ai synon nxitjen dhe përmirësimin e zbatimit të elementeve kryesore të procesit të Bolonjës në institucionet e arsimit të lartë në të gjithë Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Institucionet e arsimit të lartë (IAL) do të diskutojnë sfidat, shkëmbejnë përvojat dhe do të zhvillojnë reforma praktike së bashku me ekspertët e Bolonjës. Në këshillimin e ekspertëve të propozuar nga organizatorët, KU "Bedër" do të marrë këshillim dhe ekspertizë në tre drejtime: ndërkombëtarizimin, zhvillimin e kurrikulës dhe rezultatet e të nxënës, si dhe sigurimin e cilësisë në institucion. Në datën 31 mars 2021 është zhvilluar takimi parapërgatitor²²⁶, ku ekspertët janë njohur me Kolegjin dhe veprimtarinë e tij dhe janë përcaktuar përgatitjet që KU "Bedër" duhet të bëjë për takimet në vijim në datat 18-19 maj 2021. KU "Bedër" ka ngritur grupet e punës për të trija seksionet²²⁷ dhe po vazhdon punën për takimet e radhës.

Vlerësimi i lëndës dhe pedagogut bëhet me anë të anketës së studentit për lëndën dhe pedagogun²²⁸, e cila zhvillohet në çdo fund semestri, me anë të vetëvlerësimit të pedagogut dhe vlerësimit të tij nga ana e eprorit, brenda njësisë, me anë të formularit të vetëvlerësimit²²⁹, i cili plotësohet çdo vit nga çdo pedagog.

Vlerësimet e marra nga këto anketime janë objekt diskutimi me qëllim përmirësimin e lëndës në vitin pasardhës. Me përmirësimin e programit angazhohet edhe zyra e kurrikulave, e cila koordinon procesin e zhvillimit të kurrikulës në bazë të udhëzimit përkatës për procesin e zhvillimit të kurrikulave.²³⁰ Bazuar në të dhënat e marra nga studentët dhe stafi akademik, në institucion janë bërë përmirësime kurrikulare²³¹.

Pjesë e vlerësimit të cilësisë së programeve është edhe niveli i punësimit të të diplomuarve²³².

Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të teknikave të mësimdhënies, format e tyre parashikohen në programin mësimor të çdo lënde²³³. Ato mund të jenë në formën e leksioneve, seminareve, projekteve, detyrave të kursit, etj.

Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat

²²⁵Evidenca nr.110: Dokumenti (email konfirmues) i pranimit në projekt

²²⁶Evidenca nr.111: Relacioni i mbledhjes parapërgatitore për Bologna Hub Peer Support

²²⁷Evidenca nr.112: Lista e stafit pjesëmarrës në projektin, Bologna Hub Peer Support

²²⁸Evidenca nr.113: Formular ankete e studentit për lëndën dhe pedagogun

²²⁹Evidenca nr.55: Formulari i vetëvlerësimit të stafit


²³⁰Evidenca nr.114: Udhëzimi mbi procesin e zhvillimit të kurrikulës

²³¹Evidenca nr.115: Shembull i Ndryshimit të Kurrikulës

²³²Evidenca nr.35: Statistika mbi punësimin e të diplomuarve

²³³Evidenca nr.116: Shembull Silabusi






me studentët për çdo lëndë dhe pedagog²³⁴. Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies.

KU "Bedër" mbështet përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies duke organizuar edhe trajnime në varësi të nevojave. Gjatë periudhës së mësimdhënies në distancë, janë organizuar trajnime për përdorimin e platformës online dhe vënies në dispozicion të infrastrukturës së nevojshme.²³⁵

Kërkimi: Rezultatet e kërkimit, përhapja, vlerësimi dhe transferimi i tyre

Departamenti, si njësi bazë e institucionit, evidenton anët e tij të forta dhe dobësitë në fushën e kërkimit shkencor

Departamenti, ashtu siç parashikohet në ligjin për arsimin e lartë dhe në rregulloret e brendshme institucionale, është njësi bazë mësimore dhe kërkimore. Objekti i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Organizimi i departamentit në grupet mësimore dhe kërkimore është parashikuar në statutin e KU "Bedër", nenet 30 dhe 31. KU "Bedër" mundëson formimin e një ambienti, i cili promovon lirinë dhe autonominë akademike. Nga ana e anëtarëve të KU "Bedër" pritet një qëndrim i përgjegjshëm në kërkimin shkencor, metodologjinë dhe rezultatet për plotësimin dhe ndikimin etik të kërkimeve. KU "Bedër", me anë të udhëzimit mbi nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen efektshmërinë akademike vjetore mbi tregues transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse. Në fund të çdo viti akademik bëhet vlerësimi i performancës së stafit akademik, bazuar në reagimin e marrë në vlerësimin e punës shkencore në bazë të treguesve transparentë të botuar në rregulloret përkatëse. Një element tjetër i këtij vlerësimi është edhe raporti vjetor që realizon dhe prezanton çdo njësi bazë në rektorat, ku paraqitet veprimtaria e njësisë dhe analiza SWOT për vitin përkatës²³⁶.

Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor

Me qëllim mbështetjen e kërkimit shkencor, pranë KU "Bedër" funksionojnë disa njësi, si qendra për zhvillim të qëndrueshëm dhe inovacion, zyra e kërkimit shkencor si dhe komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin.²³⁷ Në mbështetje të kërkimit shkencor, funksionon edhe Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare

²³⁴Evidenca nr. 113: Formular ankete e studentit për lëndën dhe pedagogun

²³⁵Evidenca nr.52: Lista e trajnimeve të stafit, viti akademik 2019-2020

²³⁶Evidenca nr.5: Shembull Raporti vjetor të një njësie bazë

²³⁷Evidenca nr.20: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

(IRO). Rezultat i këtij bashkëpunimi janë projektet e organizuara brenda KU Bedër si dhe një sërë projektesh dhe konferencash të përbashkëta me institucione brenda dhe jashtë vendit²³⁸.

Institucioni përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit

Një çështje me rëndësi në ndërkombëtarizimin e kërkimit në KU "Bedër" është krijimi i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e cila me veprimtarinë e saj mundëson mobilitetin e stafit dhe të studentëve dhe funksionon sipas nenit përkatës në rregulloren për organizimin akademik²³⁹. Po kështu, organizimi i konferencave ndërkombëtare në institucion në bashkëpunim me partnerë të huaj si edhe mbështetja financiare për pjesëmarrjen e stafit në konferenca ndërkombëtare, bazuar te praktika e mbështetjes financiare²⁴⁰, janë tregues i vëmendjes që ka institucioni ndaj ndërkombëtarizimit të kërkimit.

Një hap të rëndësishëm në këtë drejtim merr aplikimi për projekte, që mbetet një nga qëllimet kryesore dhe bazohet te Rregullorja mbi Projektet Kërkimore-Shkencore^{241, 242, 243, 244}. Në këtë kuadër, KU "Bedër" ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucione dhe qendra kërkimore shkencore për projekte dhe lëvizshmëri të stafit dhe të studentëve.²⁴⁵

Institucioni përcakton fushat parësore të kërkimit shkencor

Identifikimi i fushave të kërkimit shkencor në KU "Bedër" orientohet nga disa parime. Fillimisht, udhëzimi i KU "Bedër" për nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor, në nenin 5 të tij, orienton drejt kritereve të shpërblimit për kërkimet dhe inovacionet. Së dyti, liria akademike mbetet një ndër vlerat kryesore të institucionit, të cilën KU "Bedër" e cilëson si liri për kryerjen e kërkimit shkencor, të mësimdhënies, të folurit dhe të publikimit, bazuar në standardet e kërkimit shkencor pa ndërhyrje apo ndëshkim dhe pa paragjykuar rezultatet përfundimtare të studimit. Në ushtrimin e lirisë akademike, anëtarëve të stafit akademik të KU "Bedër" u kërkohet të mbajnë qëndrim të ndershëm, etik dhe të përgjegjshëm. Gjithashtu, kërkimi shkencor asistohet nga Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, departamentet dhe Zyra e Kërkimit Shkencor. Puna kërkimore realizohet në terren dhe me punimet e

²³⁸Evidenca nr.117: Lista e konferencave shkencore

²³⁹Evidenca nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

²⁴⁰Evidenca nr.29: Procedura e mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca


²⁴¹Evidenca nr.23: Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore

²⁴²Evidenca nr.118: Lista e stafit pjesëmarrës në projekte shkencore

²⁴³Evidenca nr.119: Shembull aplikimi në projekte ndërkombëtare shkencore

²⁴⁴Evidenca nr.40: Model Certificate pjesëmarrje - SUSI

²⁴⁵Evidenca nr.37: Lista e institucioneve partnere

studentëve të masterit, sipas fushave të programeve përkatëse; ato të drejtësisë, të studimeve mediatike, ato të shkencave të edukimit, të studimeve fetare, të mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj, të cilat bashkëpunojnë me departamentet dhe Zyrën e Kërkimit Shkencor.

Institucioni zbaton prioritetet kërkimore-shkencore

Plani strategjik dhe cilësia e kërkimit shkencor përcaktojnë qartësisht objektivat që ndjek institucioni. KU "Bedër" është një institucion i arsimit të lartë që ka në fokus kërkimin shkencor dhe e mbështet atë me sigurimin e mjeteve dhe infrastrukturës së nevojshme. Elementë si salla e konferencave, muzeu i medias, pasurimi i bibliotekës në tituj, mundësimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i konferencave, i workshopeve, i trajnimeve, etj. janë shembull konkret i kësaj përpjekjeje. Gjithashtu, rekrutimi i personelit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor realizohet në funksion të strategjisë për zhvillim të institucionit. Në fund të çdo viti, njësitë bazë i paraqesin rektoratit kërkesat për personel akademik sipas kritereve që ata kërkojnë²⁴⁶.

Institucioni siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor

Kërkimi shkencor parashikuar dhe në planin strategjik të KU "Bedër" është një ndër elementët e rëndësishëm për funksionimin e aktivitetit institucional përkrah mësimdhënies dhe kontributit në shoqëri. Në këtë aspekt, rëndësi merr kërkimi shkencor, mbështetja e inovacionit, cilësia e edukimit si dhe pranimi i studentëve cilësorë. Kërkimi shkencor ka qenë në fokus të procesit akademik në KU "Bedër", ku gjatë viteve akademike i gjithë personeli ka qenë i angazhuar në punë kërkimore. Në shërbim të punës kërkimore të realizuar nga personeli akademik dhe studentët është mundësuar aksesi në "JSTOR" që lehtëson dhe inkurajon punën e vazhdueshme kërkimore. Publikimet e stafit pasqyrohen në Raportin Vjetor Institucional²⁴⁷, i cili dorëzohet në MASR dhe publikohet në faqen e internetit të institucionit.

KU "Bedër" bashkëpunon me organizmat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe mbështet pjesëmarrjen e studiuesve të rinj në organizimet e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të marrëdhënieve që ka ndërtuar me MASR, KU "Bedër" zbaton politikat shkencore rajonale dhe kombëtare duke i konkretizuar me aktivitete të realizuara dhe të tjera që planifikohen të mbahen në vijim. KU "Bedër" ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj dhe për këtë arsye ka punësuar gjatë viteve pedagogë të huaj

²⁴⁶Evidenca nr.44: Procedura e rekrutimit të stafit akademik

²⁴⁷Evidenca nr.8: Raporti vjetor institucional për vitin akademik 2017 - 2018








nga disa shtete të ndryshme të botës, si: SHBA, Anglia, Gjermania, Turqia, Spanja, Kosta Rika dhe Kosova. KU "Bedër" me anë të udhëzimit për nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen arritjet akademike vjetore për indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse. Erasmus+ ka mbështetur shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve. Gjithashtu, institucioni punon ngushtë me agjencitë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në këtë drejtim, KU "Bedër" ka nënshkruar kartën për studiuesit europianë, në përputhje me orientimin e AKKSHI-t. KU "Bedër" aplikon në mënyrë të vazhdueshme në projekte kërkimore në përgjigje të thirrjeve në fusha të ndryshme. Duke parë interesin dhe përfshirjen e vazhdueshme të studentëve në konkurset e tezave të diplomës, projekteve të organizuara si pjesë e programeve mësimore, si dhe pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore të organizuara nga KU "Bedër", por edhe jashtë tij, me vendim të Senatit Akademik është ngritur "Qendra për Kërkuesit e Rinj".^{248 249} Ajo ka për qëllim t'u ofrojë studentëve një mundësi unike për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të institucionit si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e kërkimit shkencor. KU "Bedër" fton personelin akademik vendas dhe të huaj të marrë pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura si dhe në angazhime me kohë të pjesshme.

Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor

Aktivitetet e ndryshme kërkimore dhe akademike në KU "Bedër" reflektohen në formate të ndryshme si raportet vjetore, faqja zyrtare si dhe botimet dhe librat e konferencave. Raportet vjetore të departamenteve dhe ato institucionale si dhe faqja zyrtare e institucionit, pasqyrojnë organizimin në mënyrë periodike të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të seminareve në KU "Bedër". Këtu mund të përmenden konferencat ndërkombëtare në shkencat humane dhe konferencat ndërkombëtare në shkencat e edukimit, të cilat në çdo vit kanë ardhur me një tematikë të posaçme. Konferencat janë bërë traditë 10-vjeçare e KU "Bedër". Çdo organizim kërkimor është shoqëruar me përgatitjen e librave të konferencave, të cilat janë pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare dhe u janë dërguar pjesëmarrësve të shtypura. Ato mund të gjenden edhe në faqen e internetit të KU "Bedër".²⁵⁰ Gjithashtu, publikohen në mënyrë periodike dy revista shkencore, të pajisura me ISSN. Ato janë Beder Journal of Educational Sciences- BJES (ISSN 2306-0557) dhe Beder Journal of Humanities - BJH (ISSN: 2306-6083). Punimet publikohen në faqen e

²⁴⁸ Evidenca nr.120: Vendimi i Senatit për ngritjen e qendrës së kërkuesve të rinj

²⁴⁹ Evidenca nr.121: Statuti i qendrës së studiuesve të rinj

²⁵⁰ Evidenca nr.72: Linku për aksesimin e Websiteve të revistave shkencore, <https://www.beder.edu.al/sh/content/default/revista-shkencore-8-13/8/164>








konferencave, botohen dhe u dërgohen elektronikisht autorëve si dhe janë të aksesueshme në faqen e secilës revistë.

Organizime të ngjashme janë edhe partneritetet e realizuara në rang departamenti/fakulteti me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë, janë organizuar seminare, me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të fushave përgjegjëse²⁵¹.

Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor

Me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin e ecurisë së kërkimit shkencor, pranë KU "Bedër" është ngritur Zyra e Kërkimit Shkencor²⁵², e cila harton dhe administron politikat që rregullojnë zhvillimin e kërkimeve në KU "Bedër" dhe mbikëqyr zbatimin e programeve të kërkimit, duke synuar të përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë ndikimin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe të komunitetit. KU "Bedër" në marrëveshjen kontraktuale që nënshkruan me anëtarin e ekipit akademik parashikon mbrojtjen e pronësisë intelektuale²⁵³. Në nenin 8 të kësaj kontrate, parashikohet e drejta e autorit dhe e pronësisë intelektuale. Në KU "Bedër" është ngritur edhe Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e progresit të të gjitha granteve dhe projekteve të kërkimit. Udhëzimi mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, në nenin 5 të tij, parashikon kriteret e shpërblimit për kërkimet dhe rezultatet në fushën e kërkimit shkencor. Me qëllim që personeli akademik të marrë pjesë në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit, ky i fundit përcakton edhe buxhetin. KU "Bedër" bashkëpunon me biznesin vendas dhe të huaj, si dhe merr në konsideratë faktorët ekonomikë dhe socialë. Institucioni gjatë aktivitetit akademik ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar biznesit vendas, me të cilin janë vendosur urat e bashkëpunimit. Kërkimet shkencore, siç janë konferenca shkencore ndërkombëtare të organizuara nga KU "Bedër" janë botuar në librat përkatës të konferencave, të pajisura me ISBN nga Biblioteka Kombëtare. KU "Bedër" mbështet iniciativat kërkimore të studentëve nëpërmjet organizimit të konferencave studentore dhe konkurseve të projekteve. Qendra e Kërkuesve të Rinj shërben si një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit për propozimin e iniciativave kërkimore-shkencore. Në

²⁵¹Evidenca nr.27: Shembull i Raportit të aktiviteteve të një njësie bazë

²⁵²Evidenca nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

²⁵³Evidenca nr.57: Model Kontrate me Stafin Akademik



[Handwritten signatures and initials in blue ink]

këtë kuadër, pas trajnimit të studentëve lidhur me metodat kërkimore dhe hartimin e projekteve, qendra ka organizuar konkursin e parë për propozimet e projekteve kërkimore, ku projektet fituese financohen nga KU "Bedër" ose paraqiten pranë institucioneve donatore.

Përfundimet dhe Vlerësimi

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për fushën e vlerësimit "Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi" konstaton se **standardet janë përmbushur plotësisht.**

Institucioni dëshmon se programet e studimeve zbatohen në kushte të përshtatshme dhe në mjedise të ofruara në përputhje me nevojat e programeve akademike.

Institucioni ka të përcaktuara qartë rregullat dhe kërkesat e provimit, si dhe ankimimin e rezultateve, të cilat u bëhen publike studentëve përmes rregulloreve përkatëse të botuara në faqen zyrtare Web të IAL-së.

Sistemi BIS (Bedër Information System) u siguron studentëve garantimin e rezultateve personale të provimeve, në respekt të plotë të parimit të konfidencialitetit.

Institucioni ka politika të qarta dhe siguron vlerësimin akademik, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë. Kjo bëhet përmes njësive përkatëse për sigurimin e cilësisë, si dhe duke u bazuar te standardet e cilësisë.

Vlerësimi i mësimdhënies realizohet nëpërmjet rezultateve të mbledhura nga anketat me studentë për çdo lëndë dhe pedagog, në varësi të të cilave, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të tyre.

Zyra e kurrikulave luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve.


Institucioni ka në fokus të procesit akademik kërkimin shkencor, në të cilin gjatë viteve akademike është angazhuar i gjithë ekipi. KU "Bedër" mbështet kërkimin shkencor nëpërmjet krijimit të një mjedisi që favorizon lirinë dhe autonomisë akademike, si dhe shpërblimit të arritjeve akademike vjetore mbi të dhëna transparente të parashikuara në rregulloren përkatëse.

Pranë KU "Bedër" funksionojnë disa njësi, si: Qendra "Për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion", Zyra e Kërkimit Shkencor, Qendra e Kërkuesve të Rinj, si dhe Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, të cilat mbështetin debatin dhe punën kërkimore në fushat parësore të kërkimit shkencor.

KU "Bedër" organizon në mënyrë periodike konferenca dhe aktivitete të tjera akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë, pas të cilave përgatiten librat e konferencave, të pajisur me ISBN nga Biblioteka






Kombëtare, që u dërgohen pjesëmarrësve si dhe publikohen në faqen e internetit të KU "Bedër".

Gjithashtu, publikohen në mënyrë periodike edhe dy revista shkencore, të pajisura me ISSN.

Në mbështetje të studentëve që janë angazhuar në kërkimin shkencor institucioni zhvillon konkurse, projekte të organizuara si pjesë e programeve mësimore, nxit pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore, si dhe ka Qendrën për Kërkuesit e Rinj.



M. Haxhi

G. Haxhi

[Signature]

[Signature]

[Signature]

5. FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Studentët: Nga regjistrimi deri te punësimi

Institucioni ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj

Fokusi dhe qëllimi kryesor i KU "Bedër" është përgatitja profesionale cilësore dhe me integritet e studentëve çka evidentohet qartësisht në misionin e këtij institucioni.²⁵⁴

Në përmbushjen e misionit të tij, KU "Bedër" ka hartuar politikat e pranimit të studentëve që synojnë rritjen e cilësisë së pranimit nëpërmjet thithjes dhe diplomimit të një studentëve cilësor, duke u ofruar atyre programe studimi me kurrikula që plotësojnë më së miri nevojat e tregut.²⁵⁵

Në varësi të politikave institucionale si një institucion jofitimprurës,²⁵⁶ KU "Bedër" pranon një numër të përzgjedhur studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe të burimeve njerëzore që zotëron.²⁵⁷ Përmes këtyre politikave, KU "Bedër" ka synuar angazhimin maksimal të trupës akademike dhe administrative ndaj studentit, duke respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim.

Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve të drejtpërdrejta, panairove, etj., KU "Bedër" bën publike ofertën vjetore të programeve. Në kuadër të këshillimit të karrierës, përkrah aktiviteteve të mësipërme, KU "Bedër" organizon ditët e hapura për të interesuarit, si dhe ditët e orientimit për studentët e rinj pranë ambienteve të institucionit.

Procedurat e pranimit të studentëve, kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministrisë përkatëse çdo vit akademik dhe bëhen publike përmes faqes së internetit.²⁵⁸

Në varësi të afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KU "Bedër" mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe, përmes lejeve të siguruara prej tyre, viziton shkollat e mesme në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KU "Bedër".

Me qëllim realizimin e një procesi mësimor sa më cilësor, KU "Bedër" i kushton një rëndësi të veçantë raportit numerik personel akademik/student, i cili siguron arritjen e

²⁵⁴Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 4

²⁵⁵Evidenca nr. 17: Plani strategjik institucional 2018-2023, Pika C: Pranimi i studentëve

²⁵⁶Evidenca nr.7: Statuti i KU "Bedër", neni 1

²⁵⁷Evidenca nr.97: Shembull i publikimi në Web të kriterëve të pranimit dhe dokumentacioni i nevojshëm

²⁵⁸ Evidenca nr.79: Vendim Senati mbi kriteret e pranimit



objektivave të institucionit. Raporti pedagog-student i KU "Bedër" për vitin akademik 2019-2020 është 1 pedagog për 6.8 studentë.²⁵⁹

Institucioni ndjek një politikë të informimit të studentëve dhe siguron komunikimin ndërmjet tyre dhe personelit akademik

Për të garantuar një komunikim sa më efikas dhe të shëndetshëm midis institucionit dhe studentit, KU "Bedër" ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të këshillimit. Çdo student ka një këshilltar akademik dhe karriere, të cilët e orientojnë dhe mbështesin gjatë procesit mësimor, praktikave profesionale dhe punësimit.²⁶⁰

Në momentin e nënshkrimit të kontratës, zyra e IT-së pajis me një adresë institucionale të gjithë studentët e regjistruar, gjë që u jep mundësi aksesimi dhe informimi në kohë reale përmes sistemit BIS, rrjedhimisht, njoftimet shfaqen në ekranin e gjithsecilit student.²⁶¹

Sekretaria mësimore bën afishimet e njoftimeve të ndryshme në tabelat e vendosura brenda mjediseve të institucionit, gjithashtu informon me anë të postës elektronike në adresat personale të studentëve.

Përveç kësaj, komunikimi i brendshëm kryhet edhe nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njërive bazë dhe ato kryesore.

Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, KU "Bedër" përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishme të komunikimit. Në këtë funksion, pranë KU "Bedër" shërben edhe zyra e protokollit dhe korrespondencës.

Personeli i institucionit ka një adresë elektronike të brendshme. Departamenti i IT-së pajis çdo anëtar të personelit me adresë poste elektronike të formës: Shkronja e parë e emrit, mbiemri@beder.edu.al. Gjithashtu institucioni ka përgatitur edhe guidat e nevojshme për informimin sa më të plotë të stafit dhe studentëve, të cilat mund të aksesohen edhe online.^{262 263}

Në përmbushje të kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë që në momentin e regjistrimit, KU "Bedër" plotëson dosjen personale të çdo studenti

²⁵⁹Evidenca nr.32: Lista e stafit akademik për çdo departament me gradat përkatëse

²⁶⁰Evidenca nr.11: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, neni - 18

²⁶¹Evidenca nr.64: Udhëzues i sistemit informativ Bedër (BIS)

²⁶²Evidenca nr.50: Guida e stafit

²⁶³Evidenca nr. 51: Guida e studentëve



me të gjitha informacionet e nevojshme, konform kuadrit ligjor. Dosjet në fjalë mbahen në zyrën e sekretarisë mësimore.²⁶⁴ Për mirëinformimin, komunikimin dhe transparencën në vendimmarrje, studentët janë pjesëmarrës aktiv si anëtarë të ftuar në mbledhjet e njësive bazë dhe kryesore. Po ashtu në Senatin Akademik, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe në komisionet e përhershme ata janë anëtarë me të drejta të plota.

Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve

Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KU "Bedër" ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë dekanit të studentëve. Në këtë zyrë, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar.²⁶⁵

Këshilltari i karrierës ndjek nga afër procesin e praktikave profesionale të studentëve; informon studentët mbi organizimin e seminareve të ndryshme rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësitë e punësimit për të gjithë studentët e diplomuar në programet "Bachelor" dhe "Master", organizon aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre, etj.

Programet e studimeve në KU "Bedër" janë hartuar duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në Deklaratën e Bolonjës, në mënyrë që të mundësojnë përshtatjen progresive të studentit me programin e studimit. Raporti i lëndëve në formimin e përgjithshëm profesional, teknik etj., është i vendosur, sipas këtyre standardeve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara nga MASR.

Në mënyrë periodike, KU "Bedër" informon studentët në lidhje me çdo zhvillim të rëndësishëm institucional. Metodot e informimit janë të ndryshme, si me anë të faqes së internetit, ashtu edhe me vënien në dispozicion të studentëve të materialeve ose broshurave informuese. Këto të fundit mund t'u jepen në dorë ose mund të lihen në ambientet e përbashkëta, ku studentët kanë mundësi t'i përdorin.

